EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5466
E enjte, 3 maj 2018
çmimi 0.40 €

KMDLNj-ja: Me rezoluta dhe premtime të fushatave nuk zgjidhet çështja e të pagjeturve

FAQE 11

KMDLNJ

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ

FAQE 4-5

AAK-ja u bëri ballë goditjeve të njëpasnjëshme

- AAK-ja sot është maturuar politikisht dhe besoj se është partia më e strukturuar politike në vend

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se ky subjekt politik u përball me goditje të njëpasnjëshme që prej themelimit të saj në maj të vitit 2000. Me rastin e 18-vjetorit të themelimit të AAK-së, Nitaj në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se përndjekja e vazhdueshme e liderit të saj, Ramush Haradinaj, deri edhe përpara një viti, ishte edhe goditje kundër AAK-së. Ai ka thënë se AAK-ja ka kaluar kohë të vështira, por sot është ngritur në një forcë serioze politike, duke u bërë për të dytën herë parti e kryeministrit, duke qeverisur në shtatë komuna të Kosovës dhe duke bashkëqeverisur edhe në shumë të tjera. Nitaj ka thënë se deri më tani ky subjekt politik asnjëherë nuk është shndërruar në parti klienteliste, ani edhe pse për këtë ka paguar çmim

Kosova pret vlerësim pozitiv nga delegacioni i BE-së për vizat

Për ta parë nga afër progresin në luftimin e krimit dhe korrupsionit, gjatë kësaj jave në Kosovë do të qëndrojë një delegacion i Bashkimit Evropian (BE). Me këtë rast përfaqësuesit e institucioneve, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kanë shprehur optimizëm se Kosova do të marrë vlerësim pozitiv nga delegacioni evropian sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, si kriter i fundit për liberalizimin e vizave FAQE 8-9

Ura në Mitrovicë pritet të hapet për qarkullim brenda një muaji

Ura kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, e cila ndodhet në mes të dy komunave të qytetit, asaj jugore edhe veriore, vazhdon të jetë e bllokuar për qarkullim. Sipas autoriteteve lokale atje, pritjet janë që hapja e urës për qarkullim të ndodhë qysh në muajin e ardhshëm FAQE 7

AKTUALE

KOSOVA DHE SUEDIA MBAJNË TAKIMIN VJETOR PËR REFORMAT BASHKËPUNUESE F. 5

MUNGOJNË NJOHURITË PËR SULME DHE SIGURI KIBERNETIKE F. 11

RTK-së I NDAHEN TETË HEKTARË TOKË PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË RI F. 3

EKONOMI

'ELKOS GROUP' SHËNON 30-VJETORIN E THEMELIMIT TË KOMPANISË F. 9

NË KOSOVË NUK KA STANDARD SE SA DUHET TË PESHOJË BUKA F. 8

KULTURË

PROFILI I HALIL ALIDEMËS F. 13

Prof. dr. Resmije KRYEZIU

SPORT

DRITA DHE PRISHTINA MARRIN NGA NJË PIKË, GARA PËR TITULL VAZHDON F. 18

SONTE MËSOHEN FINALISTET NË LIGËN E EVROPËS F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht – Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Aksidentohet autobusi me kosovarë në Serbi, disa të lënduar

PRISHTINË, 2 MAJ - Në afërsi të Kurshumlisë (Serbi), mëngjesin e së mërkurës, rreth orës 4:50, ka ndodhur një aksident i një autobusi me udhëtarë nga Kosova, të cilët po udhëtonin në relacionin Slloveni - Prishtinë. Të lënduarit janë dërguar në Spitalin e Prokuples, ndërsa shkaqet e aksidentit ende nuk dihen, raportojnë mediet serbe.
Autobusi i kompanisë 'R-Gashi' ka dalë nga rruga në drejtim të Nishit që po vinte për në Kosovë. Raportohet se shoferi ka humbur kontrollin e autobusit dhe ka rrëshqitur jashtë rrugës.
Nga ky aksident nëntë personа janë transportuar në spital, ndërsa tre prej tyre me thyerje të gjymtyrëve janë ndaluar për trajtim të mëtutjeshëm.
Policia serbe ka filluar hetimet, ndërsa dyshohet se shpejtësia dhe gjendja e rrugës kanë qenë shkaktarë të aksidentit.

Maqedonia mbetet në zonën e ndikimit amerikan

Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare vlerësojnë se vizita e James Mattisit është me një rëndësi të veçantë sepse në këtë nivel zyrtarët e Maqedonisë arrijnë të takohen me zyrtarët e Pentagonit pas gjashtë vjetësh dhe ky takim vjen vetëm dy muaj para mbajtjes së samitit të NATO-s

SHKUP, 2 MAJ - Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare thonë se deklarata e fundit e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, James Mattis, paraqet edhe një dëshmi për mbështetjen e fuqishme të ShBA-së për zgjidhjen e çështjes së emrit, si çështje kruciale për anëtarësimin e vendit në Aleancën veriatlantike.
Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, pas takimit me ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmilla Shekerinska, tha se "ShBA-ja e vlerëson politikën e kundërshtimit të Maqedonisë në lidhje me marrëdhëniet me Rusinë, për dëbimin e diplomatit dhe dhënien e mbështetjes aleatëve për ndalimin e agresionit rus".
Zyrtari i lartë amerikan, pas takimit me ministren Shekerinska, ka theksuar se ftesa për anëtarësim në NATO do të vijë sapo të arrihet një zgjidhje e pranueshme reciproke për çështjen e emrit me Greqinë.
Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare vlerësojnë se ky takim është me një rëndësi të veçantë sepse në këtë nivel zyrtarët e Maqedonisë arrijnë të takohen me zyrtarët e Pentagonit pas gjashtë vjetësh dhe ky takim vjen vetëm dy muaj para mbajtjes së samitit të NATO-s. Megjithatë, theksojnë se Uashingtoni ka dy porosi të qarta se ShBA-ja dëshiron ta shohë Maqedoninë në NATO, por kjo është e pamundur pa u

zgjidhur çështja e emrit. "Në vija të përgjithshme gjeostrategjike, deklarimi i vetë zyrtarëve amerikanë tregon se Maqedonia mbetet në zonën e influencës amerikane dhe se përpjekja e tyre do të jetë e vazhdueshme që Maqedonia të mbetet në këtë vijë dhe të mos rrëshqas drejt influencës ruse", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Arsim Sinani nga Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike.
Nga ana tjetër, Lubço Ristovski, ligjërues i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Shkupit, theksoi se deklarata e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, James Mattis, paraqet një porosi të qartë se duhet zgjidhur çështja e emrit, si kusht që NATO-ja t'i hapë dyert për Maqedoninë. "Unë nuk shoh ndonjë optimizëm të tepruar në deklaratën e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, James Mattis, përpos një mirënjohje që tani është më e theksuar sa i përket përpjekës që po bën Qeveria aktuale për ta ndaluar shtrirjen e influencës së Federatës Ruse në vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, ai qartë tha se duhet zgjidhur çështja e emrit si pengesë që e ndalon Maqedoninë për t'u anëtarësuar në NATO", thotë Ristovski.
Ndryshe, ministrja e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmilla Shekrinska, pas takimeve me zyrtarët e lartë të Departamentit amerikan të Shtetit, tha se Maqedonia e meriton vendin e saj në NATO ngaqë, sipas saj, është punuar shumë në këtë drejtim. "Ne kemi treguar se Maqedonia është një partnere e përkushtuar në të cilin anëtarët e Aleancës mund të llogarisin. Besojmë se ftesa për Maqedoninë për t'u anëtarësuar në NATO do të kontribuojë për stabilitetin tonë, por edhe për stabilitetin në rajon dhe do të jetë në interesin e ShBA-së", tha Shekerinska.

Rama: Sistem i pavarur drejtësie për vetting në politikë

TIRANË, 2 MAJ - Rezultatet nga reforma në drejtësi dhe vettingu do të vijnë duke u thelluar, duke pastruar sistemin nga të korruptuarit. Kështu deklaroi të mërkurën kryeministri Edi Rama, i cili, në një aktivitet për prezantimin e projekteve të reja për kryeqytetin, u ndal te reforma në drejtësi dhe vettingu. "Kemi realizuar një qëllim shumë të madh me vettingun, reformën në drejtësi, një reformë e thellë, e vështirë dhe që të tjerët as e menduan se mund të ndodhte ndonjëherë në Shqipëri. "Ne e bëmë të mundur, vijoi Rama, duke sjellë në kujtesë se - muaj me radhë kur u detyruam t'i binim rreth e qark për shkak të një çadre që bllokonte bulevardin, si pengesë e vettingut dhe zbatimit të reformës në drejtësi", tha Rama.
Reforma në drejtësi dhe vettingu tashmë ka nisur, tha kryeministri, duke shtuar se rezultatet po shihen çdo ditë dhe ato do të shkojnë duke u thelluar. "Të korruptuarit do të largohen nga sistemi. Kushdo që nuk është në gjendje ta provojë legjitimitetin e pasurisë dhe aftësinë dhe integritetin e tij, nuk do të jetë më pjesë e sistemit", tha Rama. Kjo, sipas kreut të Qeverisë, është arsye e fortë për të qenë optimist për të nesërmen.
Kryeministri garantoi se ky është vetëm fillimi, pasi pret të realizohet një sistem realisht i pavarur, efikas dhe i guximshëm drejtësie, mbi bazën e të gjitha atributeve që i jep Kushtetuta.

LSI: Integrimi, qasje kombëtare

TIRANË, 2 MAJ - "Procesi i integrimit evropian është jo thjesht një qasje politike, por një qasje kombëtare, prandaj të reflektojmë për situatën e krimit në vend, që më 28 qershor të hapen negociatat", deklaroi të mërkurën zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama, në konferencën me gazetarë pas mbledhjes së grupit parlamentar të LSI-së.
Në fjalën e tij, ai tha se grupi parlamentar i LSI-së në funksion të seancës së sotme (e enjte) të Kuvendit ka diskutuar për zbatimin e ligjit në vend.
Duke iu referuar raportit të DASh-it për Shqipërinë, Rama tha se "në raport thuhet se Shqipëria mbetet një vend në rrezik të madh për sa i përket pastrimit të parave të pista, korrupsionit të shfrenuar dhe institucioneve të dobëta".
Më tej, ai shtoi se "Qeveria e ka drejtuar gishtin ndaj sistemit të drejtësisë, mosndëshkueshmërisë dhe korrupsionit që shfaq këtë sistem, me të drejtë, por Qeveria nuk ka vepruar dhe është përgjegjëse që nuk ka krijuar Komitetin Kombëtar të Luftës Kundër Drogës". Po ashtu, ai tha se "Qeveria në vend se të marrë masa, akuzon dhe fajëson opozitën për gjendjen në vend.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kosova pret vlerësim pozitiv nga delegacioni i BE-së për vizat

Për ta parë nga afër progresin për luftimin e krimit dhe korrupsionit gjatë kësaj jave në Kosovë do të qëndrojë një delegacion i Bashkimit Evropian (BE). Me këtë rast, përfaqësuesit e institucioneve, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kanë shprehur optimizëm se Kosova do të marrë vlerësim pozitiv nga delegacioni evropian sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit si kriter i fundit për liberalizimin e vizave

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 MAJ - Këto ditë në vendin tonë do të qëndrojë një delegacion i Bashkimit Evropian për ta vlerësuar progresin e bërë për përmbushjen e kriterit për liberalizimin e vizave, përkatësisht luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, të mërkurën ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se janë duke punuar ngushtë me të gjitha institucionet në mënyrë që para delegacionit të BE-së të paraqiten sa më mirë puna dhe progresi i arritur. "Delegacioni vlerësues i BE-së do të jetë në Kosovë këtë javë, nga data 3 - 4 maj. Ai ka paraparë një agjendë të ngjeshur takimesh me të gjitha institucionet ku puna e tyre ndërlidhet me zbatimin e kriterit të rasteve të shënjezuara, ndryshe të njohur edhe si Track Record, apo lufta kundër krimit dhe korrupsionit. Po punojmë ngushtë me të gjitha institucionet për ta paraqitur sa më mirë punën dhe progresin e arritur. Kam pasur takime me të gjitha institucionet që janë të angazhuara drejtpërdrejt në zbatimin e kriterit të luftimit të krimit dhe korrupsionit, që të jemi sa më të përgatitur me rastin e vizitës së këtij misioni vlerësues nga BE-ja", ka thënë Hoxha, duke shtuar se Kosova meriton vlerësim pozitiv për luftimin e krimit dhe korrupsionit. "Çdo përpjekje për t'i goditur krimin e organizuar dhe korrupsionin duhet vlerësuar. E kam thënë edhe më herët se rruga jonë e vetme drejt integrimit është zero tolerancë ndaj krimit dhe korrupsionit në të gjitha nivelet. Besojmë se puna dhe progresi i institucioneve do të vlerësohen pozitivisht. Unë besoj se ne meritojmë vlerësim pozitiv për përpjekjet tona sa i përket kriterit për liberalizimin e vizave, por lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të vazhdojë edhe pas liberalizimit të vizave", është shprehur ajo.

Hoxha ka thënë se brenda këtij viti qytetarët do të lëvizin pa viza. "Duke u bazuar në dinamikën e procesit të vendimmarrjes nga institucionet e BE-së dhe nga proceset e liberalizimit të vizave që kanë kaluar vendet e rajonit, pres që qytetarët tanë të lëvizin të lirë deri në fund të këtij viti. Ne kemi plotësuar 95 kriteret e dhëna nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave dhe është bërë punë e madhe që disa vite. Dhe me të drejtë presim që qytetarët tanë të lëvizin të lirë deri në fund të këtij viti", ka deklaruar Hoxha.

Edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ekipi teknik nga Komisioni Evropian që do të vijë në Kosovë ka për qëllim vlerësimin e progresit të bërë për përmbushjen e kriterit për liberalizimin e vizave, përkatësisht luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ai ka thënë se duke qenë se është ekip teknik, vlerësimi i tyre, si dhe i Komisionit Evropian do të ketë qasje rekomanduese, pastaj u mbetet vendeve anëtare një nga një që ta determinojnë dhënien apo mosdhënien e liberalizimit të vizave. Megjithatë, Tahiri pret që Kosova t'i marrë kredencialet e duhura nga ky mision. "Konsideroj se që nga kalimi i marrëveshjes së demarkacionit është krijuar një moment i ri për të gjitha institucionet, veçmas për institucionet e sistemit të drejtësisë të cilat kanë reflektuar dhe kanë marrë përsipër përgjegjësitë e veta për të qenë më fleksibile dhe për ta dinamizuar agjendën institucionale në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Institucionet e sistemit të drejtësisë nuk do të zihen në befasi nga ky mision dhe se ka mjaftueshëm dëshmi konkrete që përpjekjet e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit si dhe politikat legjislative të sponsorizuara nga Ministria e Drejtësisë, vërtet janë duke bërë një dallim të madh, efektet dhe rezultatet e të cilave natyrisht se presim që do t'i marrin kredencialet e duhura nga misioni vlerësues dhe, rrjedhimisht, deri në fund të këtij viti qytetarët tanë të kenë mundësi të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen", ka deklaruar Tahiri. Ai ka bërë me dije se në rrafshin praktik prokuroria dhe gjyqësori kanë punuar në mënyrë të vazhdueshme për ta avancuar më tutje zgjidhjen e rasteve të shënjestruara të cilat paraqesin indikacion të qartë për kapacitetet dhe gatishmërinë e Republikës së Kosovës për t'i luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ministri Tahiri ka vlerësuar se ky mision do të jetë një mundësi e mirë për t'ia bërë të njohura para Bashkimit Evropian edhe politikat legjislative që janë ndërmarrë në fushën e sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit e keqpërdorimit të parasë publike. "Pak kohë më parë është miratuar në Qeveri Kodi Penal me ndryshime, i cili tashmë është në agjendën e Kuvendit për miratim dhe në të cilin projektkod kemi ndryshuar shumë masa që mundësojnë luftim më kuptimplotë kundër korrupsionit. Janë ndryshuar 19 nene që lidhen me luftën kundër korrupsionit, janë rritur dënimet për veprat që lidhen me korrupsionin dhe janë vendosur norma që mundësojnë suspendimin e zyrtarëve publikë në rast të aktakuzave për korrupsion apo keqpërdorim të detyrës zyrtare. Me dinamikë jemi duke punuar edhe në Kodin e Procedurës Penale, për të mundësuar efikasitet më të madh në punën e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit", ka thënë Tahiri. Sipas tij, gjyqësori tashmë do të përjetojë një epokë të re falë ndryshimeve legjislative që tashmë janë miratuar në Kuvend, në kuadër të pakos së ligjeve të gjyqësorit. "Po ashtu, kemi përmbushur obligimet tona nga Agjenda e Reformave Evropiane duke hartuar dhe miratuar në Kuvend Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, ku veçmas ky i fundit do ta mundësojë shtimin e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht luftim më efikas të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për të mos u mjaftuar me kaq, kam hartuar edhe një pako të ligjeve kundër korrupsionit, ku bëjnë pjesë Projektligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Projektligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë", ka deklaruar Tahiri. Ai ka bërë me dije se të gjitha këto masa legjislative që ka ndërmarrë, e fuqizojnë shtetin e së drejtës në kuptimin e përgjithshëm. "Veçmas fuqizojnë vendosmërinë tonë për luftë të pakompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, realitete këto që jam i bindur se do t'i marrin kredencialet e duhura edhe nga misioni vlerësues. Kjo vendosmëri e jona natyrisht se do të prodhojë efekte në shumë rrafshe, pa dyshim se do të mundësojë edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë në Bashkimin Evropian brenda këtij viti", ka theksuar ministri Tahiri.

RTK-së i ndahen tetë hektarë tokë për ndërtimin e objektit të ri

PRISHTINË, 2 MAJ - Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) kanë lidhur një marrëveshje mirëkuptimi për ndërtimin e ndërtesës për nevojat e transmetuesit publik. Kjo marrëveshje ka për qëllim realizimin e projektit kapital të kësaj ndërtese, në sipërfaqe prej tetë hektarësh, që shtrihet në zonën "Prishtina e re". Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i MAP-it, Mahir Jagxhillar dhe drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Mentor Shala. Sipas kësaj marrëveshje, MAP-i obligohet ta sigurojë lokacionin në të cilin do të ndërtohet ndërtesa bazuar në vendimin e Komunës së Prishtinës. Ndërsa RTK-ja obligohet ta financojë hartimin e projektit dhe të ndërtesës në harmoni me planin urbanistik.

Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

AAK-ja u bëri ballë godi

- AAK-ja sot është maturuar politikisht dhe besoj se është partia më e strukturuar politike në vend

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se ky subjekt politik u përball me goditje të njëpasnjëshme që prej themelimit të saj në maj të vitit 2000. Me rastin e 18-vjetorit të themelimit të AAK-së, Nitaj në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se përndjekja e vazhdueshme e liderit të saj, Ramush Haradinaj, deri edhe përpara një viti, ishte edhe goditje kundër AAK-së. Ai ka thënë se AAK-ja ka kaluar kohë të vështira, por sot është ngritur në një forcë serioze politike, duke u bërë për të dytën herë parti e kryeministrit, duke qeverisur në shtatë komuna të Kosovës dhe duke bashkëqeverisur edhe në shumë të tjera. Nitaj ka thënë se deri më tani ky subjekt politik asnjëherë nuk është shndërruar në parti klienteliste, ani edhe pse për këtë ka paguar çmim

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 MAJ - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se që nga themelimi ky subjekt politik u ka qëndruar besnik parimeve të veta politike. Me rastin e 18-vjetorit të themelimit të kësaj partie, ai ka vlerësuar se gjatë kësaj periudhe AAK-ja çdoherë ka qenë në shërbim të qytetarëve dhe anëtarësisë së vet.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka thënë se ky përkushtim e ka mbajtur deri më tani këtë parti në skenën politike të vendit. "AAK-ja është mbajtur herë me rënie e herë me ngritje, por gjithmonë e ka ruajtur konsistencën e vet. Besoj se asnjëherë nuk ka devijuar nga parimet e veta politike, duke qenë në shërbim të qytetarëve dhe anëtarësisë së vet. Ndoshta pikërisht kjo e ka mbajtur fuqishëm në skenën politike të vendit", ka thënë Nitaj, i cili është edhe anëtar i kryesisë së AAK-së. Ai ka vlerësuar se kjo parti i ka dhënë vlerë spektrit politik në vend.

Sipas Nitajt, AAK-ja tani është maturuar si forcë politike dhe tashmë është pjesë e pakontestueshme e spektrit politik në vend. "Duke kaluar faza e kohë të vështira, sot është ngritur në një forcë serioze politike, duke u bërë për të dytën herë parti e kryeministrit, duke qeverisur në shtatë komuna të Kosovës dhe duke bashkëqeverisur edhe në shumë të tjera. AAK-ja është maturuar si forcë politike dhe tashmë është pjesë e pakontestueshme e spek-

tjeve të njëpasnjëshme

trit politik në vend", ka thënë ai.
Nitaj ka përmendur edhe sfidat me të cilat është përballur kjo parti politike. "Sfida më e rëndë ka qenë përndjekja e vazhdueshme e liderit të saj, Ramush Haradinaj, por edhe e disa eksponentëve të tjerë të partisë. Ju kujtoj se që nga viti 2005 e deri para një viti Ramush Haradinaj nuk është lënë ta drejtojë në mënyrë të efektshme partinë. Kjo ka bërë që AAK-ja për tetë vjet radhazi të jetë në opozitë dhe kjo është një sfidë tjetër për të", është shprehur deputeti i AAK-së.
Më tej, Nitaj ka folur edhe për përgjegjësitë që kjo parti tashmë ka në Qeveri si udhëheqëse e ekzekutivit. Sipas tij, ardhja e liderit të kësaj partie, Ramush Haradinaj, në krye të Qeverisë, do ta fuqizojë AAK-në. "Sigurisht kur partia politike shndërrohet në parti të kryeministrit të vendit, është maja e suksesit. Është maja e suksesit dhe sfida e të qëndruarit vertikalisht në politikë. Unë besoj se efektet pozitive të qeverisjes Haradinaj po do të dalin në shesh dhe ngadalë, por sigurt, do të zbehen zërat kritikë ndaj saj. Unë i besoj Qeverisë Haradinaj, prandaj i besoj edhe forcimit të AAK-së. Elektorati në Kosovë ka ditur edhe t'i ndëshkojë qeveritë e shkuara. Haradinaj sot i ka të gjitha mundësitë që të mos e bëjë gabimin e paraardhësve", ka thënë Nitaj.

"Epoka e re": *Z. Nitaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të enjten shënon 18-vjetorin e themelimit. Cili ka qenë roli i këtij subjekti politik deri më tani?*
Nitaj: AAK-ja për gjithë këto vjet ishte pjesë e të gjitha proceseve në vend. E sfiduar si asnjë parti tjetër, ajo u përball me goditje të njëpasnjëshme që prej themelimit të saj në maj të vitit 2000. Përndjekja e vazhdueshme e liderit të saj, Ramush Haradinaj, deri edhe përpara një viti, ishte edhe goditje kundër AAK-së. Ajo, duke kaluar faza e kohë të vështira, sot është ngritur në një forcë serioze politike, duke u bërë për të dytën herë parti e kryeministrit, duke qeverisur në shtatë komuna të Kosovës dhe duke bashkëqeverisur edhe në shumë të tjera. AAK-ja është maturuar si forcë politike dhe tashmë është pjesë e pakontestueshme e spektrit politik në vend. Ju dhe gazeta juaj jeni kronistë të vëmendshëm dhe e keni vërejtur se AAK-ja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në të gjitha fazat që nga viti 2000. Thash dy herë e ka drejtuar Qeverinë e vendit. Ka nxjerrë tre kryeministra dhe ka drejtuar dikastere të rëndësishme në ekzekutiv. Ka udhëhequr me komuna të rëndësishme në Kosovë. Në zgjedhjet e fundit lokale, vetëm për 14 vota e kemi humbur vendin e parë si parti politike. Dua të them se AAK-ja nuk është parti me korrespondencë, por konsistente dhe serioze. Unë them se ajo i ka dhënë edhe sharmë, edhe vlerë spektrit politik në vend.

"Epoka e re": *Cilat kanë qenë sfidat me të cilat është përballur deri më tani ky subjekt politik?*
Nitaj: Sfida më e rëndë ka qenë përndjekja e vazhdueshme e liderit të saj, Ramush Haradinaj, por edhe e disa eksponentëve të tjerë të partisë. Ju kujtoj se që nga viti 2005 e deri para një viti, Ramush Haradinaj nuk është lënë ta drejtoj në mënyrë të efektshme partinë. Kjo ka bërë që AAK-ja për tetë vjet radhazi të jetë në opozitë dhe kjo është një sfidë tjetër për të. Por, pavarësisht prej kësaj, AAK-ja është mbajtur herë me rënie e herë me ngritje, por gjithmonë e ka ruajtur konsistencën e vet. Besoj se asnjëherë nuk ka devijuar nga parimet e veta politike, duke qenë në shërbim të qytetarëve dhe anëtarësisë së vet. Ndoshta pikërisht kjo e ka mbajtur fuqishëm në skenën politike të vendit!

"Epoka e re": *Sa ka ndryshuar AAK-ja gjatë këtyre 18 vjetëve?*
Nitaj: Ka ndryshuar goxha. Shumë njerëz kanë dalë e kanë hyrë në AAK. Të mos i përmend me emra, sepse opinioni publik i di, por kjo parti u ka dhënë shumë edhe partive e institucioneve të tjera. AAK-ja sot është maturuar politikisht dhe unë besoj se është partia më e strukturuar politike në vend. Asnjëherë deri më sot nuk është shndërruar në parti klienteliste, edhe pse për këtë ka paguar çmim.

"Epoka e re": *Tani lideri i kësaj partie është kryeministër i vendit. Çfarë do të thotë kjo për AAK-në?*
Nitaj: Sigurisht kur partia politike shndërrohet në parti të kryeministrit të vendit, është maja e suksesit. Është maja e suksesit, por edhe sfida e të qëndruarit vertikalisht në politikë. Unë besoj se efektet pozitive të qeverisjes Haradinaj po dalin në shesh dhe ngadalë, por sigurt, do të zbehen zërat kritikë ndaj saj. Unë i besoj Qeverisë Haradinaj, prandaj i besoj edhe forcimit të AAK-së. Elektorati në Kosovë ka ditur edhe t'i ndëshkojë qeveritë e shkuara. Haradinaj sot i ka të gjitha mundësitë që të mos e bëjë gabimin e paraardhësve. Nuk e ka aspak të lehtë, por unë i besoj energjisë së tij.

Kosova dhe Suedia mbajnë takimin vjetor për reformat bashkëpunuese

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Ministria e Integrimit Evropian dhe Ambasada e Suedisë në Kosovë kanë mbajtur të mërkurën takimin vjetor ndërmjet Suedisë dhe Kosovës në kuadër të bashkëpunimit reformues Suedi - Kosovë si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit për reformim gjatë ?2014-2020.
Në hapje të takimit ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se qëllimi kryesor i bashkëpunimit për reformim ndërmjet Suedisë dhe Kosovës është mbështetja e proceseve të integrimit në BE dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për qytetarët. "Sot e konfirmuam përkushtimin tonë të dyanshëm për t'i orientuar reformat në tri fusha kryesore: zhvillimi ekonomik dhe i sektorit privat, demokracia dhe të drejtat e njeriut, si dhe mjedisi dhe ndryshimet klimatike. Mbështetemi në mbështetjen e vazhdueshme të Suedisë dhe presim ta shtojmë bashkëpunimin në vitet e ardhshme tek hyjmë në një fazë thelbësore të procesit të integrimit tonë", ka thënë ajo.

Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Henrik Nilsson, ka bërë me dije se Suedia i jep prioritet të lartë barazisë gjinore, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. "Lehtësimi i tregtisë është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, sidomos për ekonomitë në tranzicion. Zhvillimi i sektorit privat është thelbësor. Shpresoj të ketë më tepër biznes ndërmjet Suedisë dhe Kosovës në të ardhmen. Siguria, drejtësia, qeverisja demokratike, shoqëria civile pluraliste, të drejtat e njeriut, përfshirë ato të komunitetit LGBTI, janë sektorë kyçë", ka thënë Nilsson.
Marrëveshja e bashkëpunimit për reformim ndërmjet Suedisë dhe Kosovës ?2014-2020, e cila është një harmoni me strategjinë e bashkëpunimit për reformim ?2014-2020, është në përputhje me Agjendën e Reformave Evropiane si dhe zbatimin e MSA-së. Gjatë takimit, delegacionet e udhëhequra nga ministrja Hoxha dhe ambasadori Nilsson shqyrtuan përparimin e arritur për realizimin e asistencës suedeze ?2014-2020 në shumë prej 8-10 milionë eurosh në vit. Delegacionet konfirmuan se asistenca po zbatohet sipas planifikimit, me 30 programe dhe projekte në realizim e sipër.

Norma e inflacionit shënon rritje edhe në Kosovë

Shkruan: Aulona SADIKU

Indeksi i çmimeve të konsumit në Eurozonë për muajin mars ka shënuar rritje për 1.4 për qind nga 1.1 për qind sa ishte në muajin shkurt të po këtij viti. Rritja e normës së inflacionit erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve të komponentëve kryesorë si ushqimi, alkooli dhe tobacco që shënuan rritje prej 2.2 përqindësh në muajin mars, nga 1 për qind sa ishte në shkurt. Po ashtu, rritje kanë shënuar edhe shërbimet nga 1.3 në 1.5 për qind në mars dhe energjia nga 2 në 2.1 për qind.

Për Bankën Qendrore kjo rritje e normës së inflacionit konsiderohet të jetë një mbështetje për faktin se ndikon në reduktimin e stimujve monetarë, duke qenë se rrit konsumin dhe e ul vlerën e borxhit qeveritar, si dhe rrit mbledhjen e taksave. Por, edhe pse inflacioni në kohë të shkurtër e ndihmon ekonominë, nëse një dukuri e tillë vazhdon për një kohë do të shndërrohet në problem edhe për Bankën Qendrore.

Sa i përket Kosovës, çmimet u rritën më shpejt për ushqime dhe pije joalkoolike (0.7 për qind nga 0.6 për qind në shkurt) dhe transportin (1.4 për qind nga 1.1 për qind); dhe inflacioni ishte stabil për pije alkoolike dhe duhani (1.9 për qind, e njëjta si në shkurt), restorant dhe hotele (1.5 për qind, të njëjta si në shkurt) dhe arsim (0.8 për qind, të njëjta si në shkurt). Përveç rritjeve, në Kosovë pati edhe rënie të çmimeve. Çmimet ranë me ritme më të shpejta për mobiliet dhe pajisjet shtëpiake (-0.3 nga -0.6 për qind), strehim dhe shërbimet (-4.9 për qind nga -5.3 për qind), rekreacioni dhe kultura (-1.7 për qind nga 1.5 për qind) dhe komunikimi (- 1 për qind nga -1.1 për qind).

Duke qenë se importet e Kosovës nga vendet e BE-së arrijnë 44.7 për qind e importeve të përgjithshme, vlerë e cila është një tregues se edhe rritja në çmime konsiderohet të jetë e importuar nga Eurozona dhe kjo shpjegon pse të dhënat e lartpërmendura të Kosovës kanë shumë ngjashmëri me ato të Eurozonës.

Në anën tjetër, dallimet në normën e inflacionit të sektorëve janë të pranishme duke qenë se një pjesë e mbetur e importeve totale është nga vendet si: Turqia, Kina dhe importet nga vendet e CEFTA-s, të cilat tregojnë ndikimin e tyre në normën e inflacionit. Megjithatë, norma e inflacionit mbetet shumë më poshtë objektivit të çmimeve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) prej vetëm dy për qind. Banka Qendrore përpiqet me një politikë monetare shumë liberale që ta rrisë inflacionin.

(Autorja është studente e RIT Kosova)

Përkujtohet masakra e Studimës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

VUSHTRRI, 2 MAJ - Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë përkujtuar 19-vjetorin e masakrës së Studimës, të Komunës së Vushtrrisë.

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ishin të pranishëm të mërkurën në fshatin Studime, ku janë vrarë dhe masakruar 116 shqiptarë.

Në përvjetorin e një prej masakrave më të rënda që ka përjetuar populli shqiptar gjatë luftës çlirimtare të viteve 1998-'99, para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Haradinaj ka shprehur përkushtimin institucional, që familjet e dëshmorëve dhe gjithë të rënëve, të kenë një trajtim më të mirë ligjor e institucional.

"Këto ditë është më aktuale një marrëveshje finale Kosovë - Serbi për statusin e Kosovës të cilën e kemi deklaruar se çfarë është, për një marrëveshje ligjore, që do t'i hapte rrugën Kosovës drejt anëtarësimit në BE, NATO dhe OKB. Po bëhet një pyetje se çka do të japë Kosova për këtë marrëveshje. E vërteta është se Kosova ka dhënë shumë, ja ku është dëshmia. Për këtë Kosovë që kemi sot, janë këto jetë njerëzish, janë këto dhimbje që i kanë familjet dhe ata fëmijë që janë rritur jetimë, ato nëna e motra që me dhimbje të madhe i kanë kaluar këto vjet. Që janë përballur edhe me jetën e vështirë, me mungesën e një vendi të punës dhe shtëpisë, me shqetësimin e fëmijëve të tyre se si kanë me u rritë, por edhe me dhimbjen për më të dashurit e vet", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se si drejtues lokal do të jenë gjithmonë pranë familjarëve, do të përkrahin çdo iniciativë e studim për ta përjetësuar kujtimin për martirët e vrarë në masakrën e 2 majit në fshatin Studime.

Në emër të familjarëve të martirëve të rënë në këtë masakër, Latif Gërxhaliu ka theksuar se si familjarë e kanë të vështirë të gjejnë fjalë e t'u drejtohen të pranishmëve në këtë tubim, por pikëllimi dhe mendja e tyre është gjithmonë këtu dhe të rënët në këtë masakër bënë që vendi të çlirohet.

Masakrën e Studimës e kanë kujtuar edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeparlamentari Kadri Veseli. Ata kanë theksuar se institucionet e Kosovës nuk do të ndalen derisa të dalin para drejtësisë autorët e krimeve.

Naim Bardiqi, kryesues i Bordit Drejtues të Sigurimeve Shëndetësore

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Pas emërimit ditë më parë nga ana e Qeverisë së Kosovës të Bordit të Sigurimeve Shëndetësore (FSSh), në Ministrinë e Shëndetësisë është mbajtur të mërkurën takimi i parë i këtij bordi që është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit në pajtim me Ligjin për Sigurimin Shëndetësor.

Në këtë takim konstituiv anëtarët e Bordit janë njoftuar nga ushtruesi i detyrës së Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Fatmir Plakiqi, lidhur me përgjegjësitë e këtij organi, ndërkohë që me vendim unanim të anëtarëve të Bordit, kryesues i Bordit, në bazë të parimit të rrotacionit për vitin e parë, do të jetë dr. Naim Bardiqi, përfaqësues i MSh-së në këtë bord.

Po në këtë takim Bordi ka vendosur të fillojnë përgatitjet për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i cili njëherësh do të jetë edhe sekretar i Bordit të Fondit pa të drejtë vote, si dhe për disa çështje teknike që lidhen me punën e Bordit.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 11/42, të datës 19 prill 2018, Bordi Drejtues i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore ka këtë përbërje: Naim Bardiqi nga Ministria e Shëndetësisë, Xhevat Zejnullahu nga Ministria e Financave, Izedin Bytyqi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Rrezart Halili nga Oda e Mjekëve të Kosovës, Naim Ismaili nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Muhamedali Kodra nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve të Kosovës. Mandati i të emëruarve në Bordin Drejtues është trevjeçar.

Ura në Mitrovicë pritet të hapet për qarkullim brenda një muaji

Ura kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, e cila ndodhet në mes të dy komunave të qytetit, asaj jugore edhe veriore, vazhdon të jetë e bllokuar për qarkullim. Sipas autoriteteve lokale atje, pritjet janë që hapja e urës për qarkullim të ndodhë qysh muajin e ardhshëm

Mitrovicë, 2 maj - Kryetari i komunës së jugut në Mitrovicë, Agim Bahtiri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", se aktualisht nuk ka ndonjë pengesë tjetër për funksionalizimin e kësaj ure, përveç punëve të cilat pritet të përfundojnë së shpejti në pjesën veriore të qytetit. Ai ka thënë se në fillim të muajit qershor, të dy kryetarët e komunave, bashkë me një përfaqësues të Bashkimit Evropian i cili është financues i projektit, do ta bëjnë zyrtarisht hapjen e urës. "Mendoj se punët janë duke shkuar mbarë e mirë dhe do të përpunojnë në këtë muaj. Në muajin e ardhshëm do të bëhet hapja e urës", ka thënë Bahtiri, i cili ka hedhur poshtë pohimet se punimet në urë po vonohen për shkak të ndikimit nga ana e Serbisë dhe dialogut politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në Qeverinë e Kosovës thonë se ekziston një vullnet dhe gatishmëri e madhe që sa më parë ura mbi lumin Ibër të jetë funksionale. "Për ne si Qeveri e Kosovës ekziston një vendosmëri e mirëfilltë që kjo urë të funksionalizohet sa më shpejt, që lëvizja e lirë e qytetarëve të ndodhë dhe presim nga Brukseli si garantues i kësaj marrëveshjeje, që të ushtrojë presion mbi Serbinë që të ndodhë funksionalizimi i saj", ka thënë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka thënë se mund të ketë edhe punë të tjera teknike të cilat nuk kanë përfunduar, por lëvizja e lirë e njerëzve jo vetëm brendapërbrenda një territori të shtetit të pavarur, por edhe në një kontekst global është më se e rëndësishme. "Prandaj një pengesë e tillë duhet të mënjanohet sa më shpejt", ka thënë Hoxhaj.

Maja Fićović (RFE/RL)

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, mendon se Serbia është ajo e cila po vonon dhe bllokon funksionalizimin e urës në Mitrovicë. Sipas saj, për rifunksionalizimin e urës duhet t'i vihen kushte Serbisë. "Hapja e urës është e bllokuar nga Serbia, siç është e bllokuar edhe energjia, kadastrat, diplomat dhe shuarja e strukturave paralele në shëndetësi dhe në arsim. Serbia i ka bllokuar këto, ndërkohë që Kosova ka filluar hartimin e statutit të Asociacionit. Tani Kosova duhet t'i kërkojë Bashkimit Evropian që Serbisë t'i japë një agjendë kohore kur do ta zbatojë marrëveshjen për energjinë dhe marrëveshjet e tjera. Pra, pala e Kosovës duhet të angazhohet maksimalisht", ka thënë Tahiri për "REL".

Lidhur me këtë çështje, zyrtarët nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë nuk kanë dhënë një përgjigje se kur mund të lirohet tërësisht për qarkullim ura mbi lumin Ibër.

Në pjesën veriore të Mitrovicës, sipas autoriteteve lokale, po vazhdojnë punimet në kuadër të ndërtimit të zonës së re urbane tek ura mbi lumin Ibër dhe hapësira përreth. Punimet e reja pasuan rrënimin e murit në këtë pjesë, i cili ishte ndërtuar ilegalisht nga autoritetet lokale të Mitrovicës veriore.

Ndërtimi i tij pati nxitur reagime të ashpra në Prishtinë.

Tani konstruksioni i ri përbën një ndërtim betoni prej 53 metrash të gjatë, kurse lartësia do të jetë nga 40 deri në 70 centimetra.

Zgjerohet perimetri i kërkimeve për dy policët e zhdukur

Han i Elezit/Kaçanik, 2 maj - Policia e Kosovës ka bërë me dije të mërkurën se perimetri i hetimeve në kërkim të dy policëve të zhdukur është zgjeruar edhe në ditën e katërt. Kërkimet janë duke u bërë në lumin Lepenc, ku dyshohet se mund të kenë rënë trupat e policëve dhe në zonën malore.

Edhe gjatë së mërkurës janë bërë hetime nga pjesëtarë të policisë, të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe qytetarë vullnetarë. Policia ka njoftuar se në vendin e ngjarjes dhe në zonën malore është hapur perimetri i kërkimeve, kurse pjesa tjetër e njësiteve prej kilometrit të pestë dhe nga kufiri i Maqedonisë për herë të dytë është duke u kontrolluar. Në kërkim po marrin pjesë 150 persona.

Policët e aksidentuar kanë qenë në një makinë zyrtare në magjistralen Hani i Elezit - Kaçanik, më pas vetura ka rënë nga ura e lumit Lepenc.

Zirjeta Hajro Jajaga (RFE/RL)

Mbahet tryeza për "Cilësinë e bukës në Kosovë"

Në Kosovë nuk ka standard se sa duhet të peshojë buka

Në tryezën e organizuar për "Cilësinë e bukës në Kosovë" është bërë me dije se në vendin tonë nuk ka standard se sa duhet të peshojë buka apo se në çfarë sasie duhet të ketë aditiv. Pjesëmarrësit në këtë tryezë theksuan se për këtë gjë përgjegjës është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), e cila duhet t'i mbikëqyrë prodhuesit e bukës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 2 maj - Me iniciativë të deputetit të Grupit të Deputetëve të Pavarur (GDP), Salih Salihu, dhe në bashkëpunim me Drejtorinë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv të Kuvendit, të mërkurën është mbajtur tryeza për "Cilësinë e bukës në Kosovë". Drejtori në Drejtorinë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv të Kuvendit, Arben Loshi, ka folur për Ligjin në Republikën e Kosovës dhe në vendet e rajonit për ushqimin dhe miellin. Ai ka thënë se Ligji Nr. 04/L-114 për Pasurimin e Miellit përcakton rregullat që zbatohen për pasurimin e miellit si mënyra që kanë për qëllim parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve që shkaktohen nga mungesa e hekurit dhe acidit folik. "Paketimi i miellit duhet të bëhet sipas rregullave që sigurojnë ruajtjen e vitaminave dhe mineraleve, pra sipas standardeve ndërkombëtare. Paketimi i miellit duhet të përmbajë këto informata në etiketë: tipin e miellit, përmbajtjen dhe sasinë e elementeve shtesë në miell, lagështinë dhe hirin, shkallën e aciditetit, datën e prodhimit, të skadimit dhe kushtet e ruajtjes", ka thënë Loshi.

Kurse iniciuesi i kësaj tryeze, Salih Salihu, i cili është edhe anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, ka thënë se përveç mishit si produkt i rëndësishëm në tryezën e ushqimit, rol të rëndësishëm dhe esencial për qytetarët e vendit është edhe buka si artikull i përditshëm në tryeza familjare. Ai ka shtuar se vendet e varfra bukën e kanë artikullin më të rëndësishëm ditor për nevoja për ushqim. "Buka e bardhë në vendet perëndimore është duke u zëvendësuar me bukën e zezë. Në fakt buka është duke u larguar në përgjithësi nga tryeza dhe duke u zëvendësuar me të tjera produkte si orizi, patatja etj", është shprehur ai.

Salihu ka thënë se Kosova ka nevojë për 400 mijë tonë miell në vit sepse, sipas tij, një njeri me moshë madhore në vit shpenzon 350 deri në 400 bukë, ose 1 deri në 2 bukë në ditë. Duke iu referuar të dhënave doganore, Salihu ka thënë se 4 000 tonë aditiv hyjnë në Kosovë brenda një viti. Ai ka shtuar se në Kosovë nuk ka standard se sa duhet të peshojë buka apo se në çfarë sasie duhet të ketë aditiv, dhe për këtë, Salihu ka thënë se përgjegjës është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për mosmbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji nga prodhuesit e bukës. "Ligji për aditiv ekziston, por nuk është duke u zbatuar, sepse nuk është marrë askush me të. Nuk është e precizuar se sa aditiv duhet të shpenzohet dhe për këtë është përgjegjës është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë", ka thënë ai.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, Daut Haradinaj, ka thënë se duhet të mbështetet iniciativa ligjore për të pasur cilësi të ushqimit dhe, sipas tij, AVUK duhet të jetë më e kujdesshme për zbatimin e ligjit, sepse detyra e komisionit nuk është të këshillojë, por të merren masa ndaj tyre për moskontroll të ushqimit. "Nuk është qëllimi që të dëmtohen prodhuesit e grurit, sepse asnjë deputet nuk është i interesuar ta bëjë këtë. Ligji është për të mirën e përbashkët dhe ne duam t'ju mbështesim për ta rritur cilësinë, por ne nuk jemi të kënaqur deri më tani në këtë aspekt", ka thënë Haradinaj.

Muhamet Farizi, drejtor ekzekutiv në Shoqatën e Mullisëve të Kosovës, ka thënë se Kosova ka traditë të bluarjes së miellit. Ai ka bërë me dije se aktualisht janë 40 mullinj të cilët kanë kapacitet të lartë. Farizi ka treguar se gruri kur vjen në mulli tatimohet në emër të bujkut me 3 për qind. Kjo, sipas tij, shfaq problem për mullisin, pasi ai është i detyruar t'ia paguajë shtetit 3 për qind.

Balija: Qasja në financim nga bankat e Kosovës, më e larta në rajon

Prishtinë, 2 maj (ER) - Sipas raportit të fundit të OECD "Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore", qasja në financimin nga bankat është më e larta në rajon. Në këtë raport për vitin 2018, sektori bankar në Kosovë vlerësohet në superlativ në kategoritë të cilat merren për bazë për përcaktimin e qasjes në financa siç është konkurrenca në sektorin bankar, kërkesat për kolateral, ofrimi i kredive dhe ndërmjetësimi në risk etj.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se kjo është një arritje e rëndësishme për sektorin bankar në Kosovë, veçanërisht kur kemi parasysh se bankat në Kosovë ofrojnë në një mjedis me sfida të shumta siç është kapaciteti i ulët ekonomik, informaliteti i lartë dhe vështirësitë për zbatimin e kontratave. "Prandaj këto rezultate të sektorit bankar janë mjaft inkurajuese pasi që rritja e qasjes në financa nënkupton lehtësim për zgjerimin e biznesve dhe plotësimin e nevojave të ekonomive familjare për financim. Kosova është vlerësuar më lart në rangim me Shqipërinë, Bosnjën dhe Malin e Zi dhe në nivel të njëjtë me Maqedoninë dhe Serbinë", ka thënë Balija.

'Elkos Group'-i shënon 30-vjetorin e themelimit

Prishtinë, 2 maj (ER) - Kompania "Elkos Group" ka shënuar të mërkurën themelimin e 30-vjetorit. Pronari i kompanisë "Elkos Group", Ramiz Kelmendi, para të pranishmëve të shumtë ka bërë një prezantim të shkurtër të fillimeve të karrierës, sfidat nëpër të cilat ka kaluar për të ardhur deri te suksesi që ka sot kompania e tij. Kelmendi ka treguar edhe për prioritetet e "Elkos Group"-it, duke thënë se presin që ta hapin një qendër të madhe tregtare në Tiranë.

I pranishëm në këtë festë ishte edhe kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se suksesi i secilës kompani në Kosovë nuk matet vetëm me profitin, por edhe me plasimin në treg dhe shitjen e prodhimit vendor. "Në 30-vjetorin e themelimit të 'Elkos Group'-it, i cili është ndër taksapaguesit dhe punëdhënësit më të mëdhenj në vend, rikonfirmova se Qeveria e Kosovës do të jetë në krah të atyre kompanive që stimulojnë punësimin dhe rritjen ekonomike. Prioritet i Qeverisë është që Kosovën ta bëjmë vend me ekonomi të zhvilluar, që prodhon dhe eksporton më shumë në tregun e jashtëm", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa bashkëpartiaku i Kelmendit, Avdullah Hoti, ka thënë se ngritja e biznesit të "Elkos Group"-it është histori e ngritjes së ekonomisë së Kosovës.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se sot po dëshmohet që "Elkos Group"-i është Evropë, është kontribut social, është mirëqenie sociale dhe është përmirësim i imazhit të Kosovës.

MPMS-ja me ligj gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara

EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

Prishtinë, 2 maj - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka raportuar të mërkurën para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me zbatimin e Ligjit për Persona të Verbër. Ai ka thënë se MPMS-ja aktualisht zbaton Ligjin nr. 04-L-092 për Personat e Verbër dhe Rregulloren nr. 02/2013 për Funksionimin e Komisionit Mediko-Social.

Ministri Reçica ka bërë me dije se në planin legjislativ të akteve nënligjore të MPMS-së për vitin 2018, është paraparë edhe ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 02/2013 si dhe vetë përbërjes së komisionit. Ai ka thënë se MPMS-ja, me qëllim të avancimit të kornizës ligjore dhe bazuar në Strategjinë Sektoriale 2018-2021 të ministrisë, planit të punës për vitin 2018, ka paraparë hartimin e konceptdokumentit për ligjin gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuar.

"Pas miratimit të këtij koncept-dokumenti do të fillojë hartimi i projektligjit të përgjithshëm, i cili do ta garantojë trajtimin e barabartë të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me normat dhe praktikat ndërkombëtare, qëllimi i të cilit është t'i mbrojë dhe promovojë të drejtat e tyre në përfitime financiare dhe të tjera", ka thënë Reçica.

Sa i përket zbatimit të Ligjit për Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, ministri Reçica ka thënë se me vendim të Qeverisë, që nga dhjetori i vitit të kaluar është caktuar kompensimi mujor në vlerë prej 150 eurosh për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe kujdestarëve të tyre personalë. Kurse rreth punësimit të personave me aftësi të kufizuar, ministri Reçica ka thënë se punësimi i kësaj kategorie nuk është i kënaqshëm si në sektorin privat, po ashtu edhe në atë publik, sidomos në këtë të fundit.

Fillon aksioni për heqjen e mbeturinave në Rahovec

RAHOVEC, 2 MAJ (ER) - Pas mbajtjes së takimeve me kryetarë të lagjeve të Rahovecit, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësueseve të operatorëve ekonomikë të cilët kanë kontrata në Komunën e Rahovecit, të mërkurën ka filluar aksioni për pastrimin e mbeturinave me moton "Ta pastrojmë Rahovecin së bashku".

Ky aksion pritet të zgjasë deri në heqjen e të gjitha "pikave të zeza" me mbeturina në tërë hapësirën e Komunës së Rahovecit.

I pranishëm në fillimin e aksionit të pastrimit të mbeturinave ishte edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, me stafin e vet, nxënëset e shkollave fillore "Ardhmëria" dhe "Isa Boletini". Aksionit i janë përgjigjur edhe punëtorët e ndërmarrjes publike KRM "Ekoregjioni" Prizren, Njësia Operative në Rahovec. Po ashtu, aksionit i janë përgjigjur qytetarë në gjithë territorin e komunës, nxënës dhe vullnetarë të Qendrës Rinore ShL-Kosova.

Haradinaj kërkon hetim rreth ndërtimit të Memorialit në Mejë

GJAKOVË, 2 MAJ (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka ftuar kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezit, ta fillojë hetimin për keqpërdorimet e mundshme rreth ndërtimit të Memorialit në Mejë të Gjakovës. Në profilin e vet në "Facebook" kryeministri Haradinaj ka prezantuar letrën që ia ka dërguar kryeprokurorit, duke shkruar se nuk do të lejohen keqpërdorimet e mundshme të degradojnë pastërtinë e luftës për liri. "Sot i jam drejtuar kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezit, që në mandatin e tij ligjor të fillojë menjëherë, në koordinim me Policinë e Kosovës, hetimin për keqpërdorimet të cilat janë shprehur si shqetësim nga banorët rreth ndërtimit të Memorialit në Mejë të Gjakovës. Ne nuk do të lejojmë që keqpërdorimet e mundshme ta degradojnë pastërtinë e përpjekjeve tona për çlirim dhe liri. Kujtesa jonë historike kombëtare është trashëgimi për brezat që vijnë", ka shkruar Haradinaj.

Ministri Ismaili nis iniciativën për qytete të shëndetshme

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Me ftesën e ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, do të qëndrojnë në Kosovë tre ekspertë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh-së) për të ndihmuar për krijimin e politikave për qytete të shëndetshme. Lajmin e ka bërë me dije ministri Ismaili. "Pas disa viteve me radhë që Prishtina renditet në mesin e qyteteve më të ndotura, disa muaj më parë unë kam marrë një iniciativë për ta ftuar Organizatën Botërore të Shëndetësisë që të na ndihmojë për krijimin e një politike për qytetet e shëndetshme (Healthy Cities), si politikë afatgjatë për ndryshimin e gjendjes në qytetin tonë. Kjo iniciativë do të shtrihet edhe në Ferizaj dhe Obiliq, mirëpo Prishtina do ta ketë rolin kryesor për krijimin e rrjetit të qyteteve të shëndetshme. Prandaj, sot nisa ditën me ekspertin e OBSh-së, profesorin John Ashton, me të cilin diskutuam mënyrat për ta arritur këtë qëllim. Qytete të shëndetshme, jetë më e shëndetshme", ka deklaruar ministri Ismaili.

Komuna e Mitrovicës subvencionon 94 fermerë me farë misri dhe pleh artificial

MITROVICË, 2 MAJ (ER) - Komuna e Mitrovicës ka mbështetur 94 fermerë, ku 79 prej tyre janë pajisur me nga një thes me farë misri dhe 100 kilogramë pleh artificial, ndërsa 15 fermerë me nga 2 thasë farë misri dhe nga 200 kilogramë pleh artificial.

Ky projekt arrin vlerën prej 6 213 eurosh, me ç'rast komuna ka ndarë fonde në shumën prej 4 970 eurosh, kurse pjesa tjetër në shumën prej 1 242.60 eurosh është siguruar nga participimi i fermerëve.

Në ceremoninë e nënshkrimit të kontratave midis komunës dhe fermerëve, i pranishëm ishte kryetari i komunës, Agim Bahtiri dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku.

Në fjalën e tij, kryetari Bahtiri u shpreh i sigurt që do të vazhdohet edhe më tutje që t'i kushtohet një angazhim i veçantë sektorit të bujqësisë. Ai u ka bërë thirrje fermerëve mitrovicas që t'u përgjigjen ftesës për bashkëpunim me kompaninë "Agroprodukti" nga Istogu, për kultivimin e bimëve mjekësore aromatike, duke i njoftuar njëkohësisht fermerët me kushtet e bashkëpunimit.

Kryetari Bahtiri ka theksuar se fermerët e interesuar farën e kanë falas nga kjo kompani dhe se përftimi i tyre do të jetë shumë i madh.

Me rezoluta dhe premtime të fushatave nuk zgjidhet çështja e të pagjeturve

KMDLNJ
NGA KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

Është bërë si rregull apo reagim refleksiv që me çdo 27 prill, në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, politikanët kosovarë dhe ata ndërkombëtarë (në mënyrë selektive), "qajnë" dhe premtojnë se kjo çështje më në fund do të zgjidhet duke i liruar familjet nga ankthi thuajse 20-vjeçar e që ky ritual të përsëritet në vitin vijues, pa ndonjë ndryshim apo lehtësim për familjet që me të drejtë kërkojnë realizimin e një të drejte elementare të njeriut, e drejta për t'u informuar e cila u mohohet që nga përfundimi i luftës.

Çështja e personave të zhdukur është dhe duhet të trajtohet ekskluzivisht si e drejtë e njeriut e që nuk është trajtuar deri më tani. Është më se e vërtetë se politika e ka shkaktuar këtë çështje dhe, për fat të keq politika është ajo që edhe mund t'i japë zgjidhje çështjes së personave të zhdukur. Gjithashtu është e vërtetë se politika, si ajo në Beograd dhe kjo në Prishtinë dhe sidomos shumëfytyrësia e ndërkombëtarëve ka ndikuar dhe po ndikon që çështja e personave të zhdukur të mbetet e pazgjidhur, duke e mbajtur situatën e tensionuar dhe duke e keqpërdorur skajshmërisht fatkeqësinë dhe vuajtjet e atyre, familjarët e të cilëve janë në listën e të zhdukurve. Deri më tani kemi pasur një qasje shumë të gabuar kur është bërë përpjekje që çështja e personave të zhdukur të zgjidhet në baza të përkatësisë etnike duke insistuar vetëm për të zhdukurit tuaj dhe duke ua mohuar këtë të drejtë të njeriut palës tjetër. Edhe këtë vit, ditës së përkujtimit për të zhdukurit në Kosovë i ka paraprirë një varg aktivitetesh të institucioneve dhe politikanëve që, fare pak apo aspak nuk dallojnë nga viti paraprak. Aktivitetet ishin të ndara në baza etnike për një çështje që është dhimbje, nevojë dhe interes për të gjitha familjet apo familjarët që kanë anëtarë të zhdukur pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, moshore, racore, statusit shoqërorë etj., Ndërkombëtarët, si oportunistë apo kalkulues që janë nuk kanë treguar fare interesim për të zhdukurit, për dallim për çështje të tjera sikur bisedimet me Serbinë, Gjykata Speciale, Demarkacioni e tash Asociacioni i Komunave serbe në Kosovë për të cilat nuk ka lënë kush nga ndërkombëtarët pa na zhbiruar birat e veshit, duke filluar nga niveli më i ulët e deri te kreu vendimmarrës, pensionistë që Kosovën e llogarisin vend relaksi dhe ringjallje të së kaluarës e deri te analistët e ndryshëm. Kuvendi i Kosovës organizoi një seancë për të zhdukurit ku u shfaq një film dokumentar për të zhdukurit e që ishte më së paku që mund të bëhej me propozim që të miratohej një Rezolutë (mbase e dështuar sikur të gjitha rezolutat tjera) mirëpo as kjo Rezolutë nuk u votua, në mungesë të kuorumit. Deputetët e papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm, duke ikur nga seanca treguan shpërfillje të skajshme dhe mungesë respekti për të zhdukurit, sakrifica e të cilëve ua mundësoi edhe të bëhen deputetë sikur që treguan përbuzje për familjet e të zhdukurve të cilët po mbesin të vetmuar në përpjekjet për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur dhe drejtësi për ta. Si të kuptohet kjo mungesë e deputetëve për një çështje aq të ndjeshme përveç si një dyfytyrësi dhe mungesë elementare të ndjenjave dhe të përgjegjësisë, qytetare dhe institucionale! Po

këta deputetë, gjatë fushatave zgjedhore, njërin ndër premtimet kryesore e kanë çështjen e personave të zhdukur, deri sa ta fitojnë mandatin. E pamë se sa shumë "brengosen" për fatin e personave të zhdukur. Këta që biseduan me Beogradin qofshin atë "teknike" apo "politike", që nga viti 2011 premtuan se çështja e personave të zhdukur do të bisedohet në Bruksel kurse tani jemi në vitin 2018 dhe jo që nuk po bëhet temë e bisedimeve por nuk janë në gjendje as ta votojnë një Rezolutë të pavlerë, së paku edhe simbolikisht, në Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur.

Ndërkombëtarët kurrë nuk u interesuan për persona të zhdukur ndonëse kishin fuqi vendimmarrëse të ndikojnë në zbardhjen e fatit për personat e zhdukur duke bërë presion te palët ndërluftuese, pas përfundimit të luftës, për të dhënë informatat për fatin e këtyre personave. As sot nuk e shfrytëzojnë këtë detyrim sepse, jo që nuk bëjnë presion te Beogradi dhe Prishtina por në heshtje, për shkak të proceseve politike këtë çështje aq të ndjeshme e kanë futur nën tepih sikur që kanë vepruar edhe në vendet e tjera ku çështja e personave të zhdukur ka mbetur brengë vetëm e familjeve dhe familjarëve. Në Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur nuk kishte ndërkombëtarë në sallën e Kuvendit të Kosovës dhe ata vepruan si shumica e deputetëve të Kuvendit, nuk erdhën fare. Në rastet e tjera si Demarkacioni dhe votimi për Gjykatën Speciale ndërkombëtarët ishin shpërndarë në të gjitha pikat e Kuvendit duke bërë presion te deputetët për të votuar në favor të Demarkacionit dhe Gjykatës Speciale.

Tashti deputetët dezertorë dhe politikanët e papërgjegjshëm po përdorin fjalë të mëdha duke kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare që të bëjë presion te Beogradi për të treguar për fatin e personave të zhdukur, mendohet për shqiptarët e zhdukur kurse për të zhdukurit joshqiptarë nuk bëjnë kërkesë të sigurohen informatat thuaja se ata nuk janë njerëz dhe se nuk kanë familje. Është jonjerëzore, kundër të drejtave të njeriut dhe e kundërligjshme të kërkohet ndriçimi i fatit të personave të zhdukur në mënyrë selektive dhe në baza etnike. Për t'u zbardhur fati i personave të zhdukur duhet një qasje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese sikur që presioni duhet të drejtohet në dy adresa, për shqiptarët dhe joserbët e zhdukur informata dhe përgjegjësi duhet të japin autoritetet në Beograd kurse për serbët e zhdukur si dhe të zhdukurit joshqiptarë që vlerësohet se kanë qenë me serbë, informata duhet të japin autoritetet në Prishtinë. Nëse zhduket një person llogaritet se mund të ketë qenë diçka e rastit kurse, nëse zhduken qindra dhe mijëra persona atëherë kjo është diçka e planifikuar, e motivuar politikisht apo etnikisht dhe përgjegjësia është lehtë e identifikueshme sikur që edhe drejtësia është gjithashtu lehtësisht e realizueshme. Kjo varet nga vullneti i atyre që i kanë informatat apo që kanë mundësi t'i sigurojnë informatat, por ky vullnet po mungon dhe, për pasojë, problemi i personave të zhdukur ka mundësi që nuk do të zgjidhet fare.

Mungojnë njohuritë për sulme dhe siguri kibernetike

Prishtinë, 2 maj (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të mërkurën takimi i Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike lidhur me raportet e tremujorit të parë të këtij vitit, të të gjitha institucioneve të cilat janë të përfshira në përmbushjen e objektiveve të përgjithshme të Strategjisë për Siguri Kibernetike.

Me këtë rast zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh koordinator Kombëtar për Siguri Kibernetike, Selami Shkodra, ka thënë se gjatë kësaj periudhe janë mbajtur disa takime të rëndësishme si jashtë dhe brenda vendit, në prezantime me qëllim të mësimit të përvojave të domosdoshme me avancimin e teknologjisë.

Zëvendësministri Shkodra ka theksuar se pavarësisht prej përpjekjeve maksimale për ngritjen e sigurisë kibernetike, me këtë hov të teknologjisë mund të konstatohet se njohuritë mbi kërcënimet e sulmeve kibernetike dhe sigurinë kibernetike në përgjithësi u mungojnë edhe një pjese të madhe të qytetarëve si dhe zyrtarëve të institucione publike.

Të gjithë anëtarët e këshillit u pajtuan se është e domosdoshme për ta ngritur sigurinë në gjitha institucionet publike, me qëllim të vlerësimit të rëndësisë që ka siguria kibernetike, duke hartuar plane konkrete të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknologjike.

Mogherini: Do ta mbrojmë lirinë e medias brenda dhe jashtë BE-së

Bruksle, 2 maj - Shefja e diplomacisë së BE-së, Federica Mogherini, me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, tha se liria e shprehjes dhe shtypit janë rrezikuar në gjithë botën. "Sulmet kundër medieve dhe gazetarëve janë sulme ndaj demokracisë dhe lirisë për të gjithë ne", tha Mogherini në një deklaratë.

Sekretari i ri i shtetit, Pompeo, bën betimin

Në ceremoninë e betimit të mërkurën në Uashington, Pompeo ka premtuar t'i japë një nxitje diplomacisë amerikane dhe të ndihmojë që Departamenti i Shtetit ta rifitojë besimin

Uashington, 2 maj - Presidenti Trump vlerësoi lart aftësitë e sekretarit të ri të Shtetit, Mike Pompeo. Ai i bëri komentet në ceremoninë e betimit të Pompeos të mërkurën në Departamentin e Shtetit në Uashington.

Presidenti Trump e quajti Mike Pompeo një patriot të vërtetë. Ai tha se Pompeo meritoi respektin dhe admirimin e të gjithëve kur punonte si drejtor i Agjencisë Qendrore të Zbulimit.

Presidenti, i cili e viziton Departamentin e Shtetit për herë të parë që nga ardhja në detyrë, shprehu besimin se Pompeo do ta realizojë me sukses misionin e lartë për ta mbikëqyrur dhjetëramija diplomatët amerikanë në të gjithë botën. Nga ana e tij, sekretari i Shtetit e quajti një shans të pashembullt faktin që një nga detyrat e tij të para në postin e ri do të jenë negociatat e pritshme me Korenë e Veriut.

Pompeo, një nxitje për diplomacinë amerikane?

Pompeo ka premtuar t'i japë një nxitje diplomacisë amerikane dhe të ndihmojë që Departamenti i Shtetit ta rifitojë besimin. Të martën qindra punonjës të Departamentit të Shtetit e përshëndetën me entuziazëm Sekretarin e ri të Shtetit.

Morali në këtë agjenci ka rënë nën kërcënimin e shkurtimeve të mëdha të buxhetit, ndërkohë që me dhjetëra poste kyçe dhe ambasadoriale janë lënë të paplotësuara nën paraardhësin e tij, ish-sekretarin Rex Tillerson.

Pompeo u prit me entuziazëm të madh nga punonjësit e agjencisë. Zëvendëssekretari i shtetit, John Sullivan, tha se Pompeo përfaqëson një kombinim të rrallë aftësish: "Ne kemi një komandant tankesh, i cili studioi pastaj drejtësi në Harvard, ku u zgjodh edhe në Bordin e Revistës 'Harvard Law'", tha Sullivan.

Zëvendëssekretari i Shtetit tha se Pompeo do të jetë një rival i vështirë për kundërshtarët e Shteteve të Bashkuara. Pompeo e filloi punën në avion, vetëm disa orë pasi u konfirmua nga Senati, pa e parë ende zyrën e tij elegante në katin e shtatë. "Thashë në dëshminë time se do të shpenzoj pak kohë në katin e shtatë - bëhet fjalë për katin e shtatë, apo jo? Do të shkoj atje pas pak", tha Pompeo.

Ai tha se ka në plan të udhëtojë shumë dhe t'u japë një nxitje diplomatëve të karrierës kudo në botë: "Trupi diplomatik i Shteteve të Bashkuara duhet të jetë në çdo cep të botës, duke kryer misione në emër të këtij vendi dhe është detyra ime e ndershme të ndihmoj që kjo të arrihet".

Pas komenteve të para për punonjësit e Departamentit të Shtetit, Pompeo u përzje mes tyre, duke u ndalur për të bërë "selfie", në kontrast të dukshëm me paraardhësin e tij të ndrojtur, Rex Tillerson.

Eksperti i politikës së jashtme Nil Gardiner thotë se Pompeo do të sjellë një diplomaci të fuqishme. "Mendoj se ai do të jetë një prani shumë më e madhe në skenën botërore sesa Rex Tillerson. Mike Pompeo është njeri që mendoj se dëgjohet shumë nga presidenti", tha ai.

Por eksperti Thomas Hill thotë se Pompeo do të ketë në një detyrë të vështirë. "Unë do të thosha se ai duhet të shkojë më tej sesa ta rikthejë besimin. Ai duhet ta bëjë modernizimin e Departamentit, ndërkohë që do t'i duhet të merret me betejat me agjencitë e tjera që do të vijnë në mënyrë të pashmangshme, si dhe me problemet normale të diplomacisë ndërkombëtare, si Irani, Koreja e Veriut, Rusia e të tjera", tha Hill.

Trupat amerikane do të mbeten në Korenë e Jugut

Uashington, 2 maj - Qeveria e Koresë së Jugut tha se trupat amerikane do të mbeten në këtë vend, edhe nëse arrihet marrëveshje për ta përfunduar zyrtarisht Luftën e Koresë. Rreth 29 000 ushtarë amerikanë ndodhen në Korenë e Jugut, në bazë të një marrëveshjeje të sigurisë, të arritur pasi ka përfunduar lufta më 1953.

Koreja e Veriut, më herët, ka kushtëzuar heqjen dorë nga armët bërthamore me largimin e trupave amerikane nga gadishulli. Por, një zëdhënës i Qeverisë jugkoreane tha se prania e tyre "nuk ka të bëjë asgjë me nënshkrimin e traktateve të paqes". "Trupat amerikane në Korenë e Jugut janë një çështje që lidhet me aleancën midis Koresë së Jugut dhe Shteteve të Bashkuara", tha zëdhënësi Kim Eui-kyeom.

Në takimin e tyre historik, të premten e kaluar, presidenti jugkorean Moon Jaein dhe ai i Koresë së Veriut, Kim Jongu, janë zotuar se do të punojnë për denuklearizimin e Gadishullit Korean dhe nënshkrimin e një traktati të paqes që do t'i jepte fund edhe formalisht Luftës Koreane.

Netanyahu akuzon Abbasin për anti-semitizëm

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, ka akuzuar presidentin e Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas, për anti-semitizëm dhe mohim të Holokaustit, pas fjalimit të Abbasit në të cilën ka thënë se persekutimi i hebrenjve evropianë është shkaktuar nga sjellja e tyre, transmeton "Reuters".

Grupet e hebrenjve kanë kundërshtuar komentet e Abbasit, i cili ka thënë se hebrenjtë kanë vuajtur historikisht jo për shkak të fesë së tyre, mirëpo për shkak se kanë qenë bankierë dhe huadhënës. "I bëj thirrje komunitetit ndërkombëtar për ta dënuar anti-semitizmin e Abbasit", ka thënë Netanyahu përmes një postimi në "Twitter".

Ambasadori amerikan në Izrael, David Friedman, ka thënë se Abbasi ka arritur "një tjetër pikë të ulët, në momentin që ka pretenduar se shkaku i masakrave ndaj hebrenjve ka qenë "sjellja e tyre".

Profili i Halil Alidemës

(Prof. dr. Hysen Matoshi, "Mr. Halil Adidema: jeta dhe veprimtaria", botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017)

Prof. dr. Resmije KRYEZIU

Stiv Jobs në një prononcim thotë: "Koha jonë është e kufizuar, prandaj mos e humb atë duke jetuar jetën e dikujt. Mos lejo që zhurma e mendimeve të njerëzve të tjerë të shurdhojë zërin tënd të brendshëm. Ki kurajë ta ndjekësh zemrën dhe intuitën tënde". Nuk e di nëse Halil Alidema i kishte lexuar këto fjalë të Stiv Jobsit, iniciatorit dhe promotorit të teknologjisë së re informatike që i ka dhënë vulë mendësisë së lirë të shekullit XX dhe XXI, por e di se Halil Alidema kishte vepruar tërë jetën e tij duke e ndjekur idealin e tij të zemrës dhe mendjes pavarësisht prej të gjitha "zhurmave" që e kishin ndjekur gjatë jetës së tij, duke nisur që nga fëmijëria. Vullneti tij ishte më i fortë se pengesat që mundoheshin t'ia kurthonin rrugët dhe t'ia shuanin zjarrin që kishte në zemër për t'i ndriçuar rrugët drejt lirisë së atdheut.

Magjistër Halil Alidema ishte njëri ndër ata që nuk pajtohej me robërinë, ishte ndër të parët, në mos i pari, që ishte i bindur se liria nuk falet dhe për te duhet luftuar me të gjitha mjetet që çojnë drejt fitores përfundimtare. Në jetën politike ai në fillim iu bashkua Lidhjes Demokratike të Kosovës, por formati politik që e ndiqte asokohe kjo parti nuk i shkonte për shtati atij, sepse ai rrugën drejt lirisë nuk e shihte në kuadër të Jugosllavisë. Këto shqetësime të ligjshme e shtyjnë ta themelojë Partinë e Unitetit Kombëtar, sepse e kishte të qartë se vetëm ashtu do të realizoheshin idealet e brezave që luftuan ndër vite.

Gama e aktiviteteve të tij ishte e gjerë dhe si i atillë synonte që ta qëllonte armikun, Jugosllavinë unitare nga të gjitha anët. Halil Alidema ishte poet, studiues, politikan, diplomat dhe si kurorë e të gjitha këtyre epiteteve ishte luftëtar i paepur i lirisë. Profesor doktor Hysen Matoshi në monografinë "Mr. Halil Adidema - jeta dhe veprimtaria" ia ka dalë që t'i ftillëzojë të gjitha shtigjet nëpër të cilat shtegtonte gjatë gjithë jetës magjistër Halil Alidema. Me thellësi të mendimit, autori Hysen Matoshi arriti që t'i ndriçojë dritëhijet e kohës që i paraprinë luftës finale për lirinë e Kosovës.



Duke ecur shtigjeve të mr. Halil Alidemës, autori, prof. dr. Hysen Matoshi, na zbulon shumë të vërteta të panjohura deri tani, duke u bazuar në dokumente, fakte të nxjerra nga arkivat dhe në burime të tjera kombëtare e ndërkombëtare.

Figura e mr. Halil Alidemës - intelektualit, luftëtarit të lirisë, që u shua më 1996, në rrethana të dyshimta në një spital të Tiranës, na ndriçohet sa nga faktet e shkruara ashtu edhe nga rrëfimet e bashkëluftëtarëve të tij dhe në këtë mënyrë ne zbulojmë se ky intelektual dhe luftëtar i paepur nuk u kënaq vetëm me shkrime, analiza politike, rrugëtime nëpër konferenca ndërkombëtare, ku e mbronte të drejtën e shqiptarëve të Kosovës, por aktivitetin e tij e shtriu edhe në përgatitje për të nisur luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës.

I ndjekur në çdo hap nga sigurimi jugosllav, ai duke dashur t'i mundësojë partisë së tij të re një hov, pas burgut largohet nga Kosova dhe tërhiqet në një ilegalitet të thellë dhe aktivitetin politik në fillim e vazhdon nga Maqedonia dhe pasi edhe atje i bien në gjurmë ai tërhiqet në Shqipëri. Edhe atje sigurimi jugosllav e ndjek hap pas hapi dhe, duke mos i mbetur hapësirë për veprim, ai i drejtohet diasporës dhe vepron kudo që ka shqiptarë në Evropë.

I bindur se lufta kundër Jugosllavisë nuk do të ishte e suksesshme nëse nuk do ta kishte edhe përkrahjen politike edhe atë ushtarake të shteteve evropiane, Halil Alidema si luftëtar dhe intelektual kontakton me personalitete të ndryshme politike, u shkruan dendur atyre, merr pjesë në konferenca ndërkombëtare, gjithsesi pa e harruar asnjëherë luftën e armatosur. Kërkon mbështetje në ato shtete që nuk ishin afër kufijve të Jugosllavisë, por që e njihnin sadopakproblemin e shqiptarëve.

Ai shtegton nga Evropa Perëndimore, në Lindjen e Mesme çdoherë duke e hequr bukën e tij të gojës me qëllim që t'iu bënte ballë udhëtimeve gjithandej. Këto lëvizje të pandërprera pikësynim përfundimtar e kishin luftën e armatosur, ndërsa me kohë u mbështetën edhe nga emigracioni shqiptar liridashës.

Shqipëria ishte shteti, të cilin Halili tërë kohën e kishte në zemër dhe që do ta mbante deri në vdekje. Ishte i bindur se vetëm nga Shqipëria do të mund të vepronte drejt Kosovës, ai përgatitet t'i presë luftëtarët e ardhshëm që do të stërviten atje për luftën që po trokiste në Kosovë.

Mbi këtë platformë ai gjeti mbështetje edhe nga stafi ushtarak që nuk ishte aktiv në Ushtrinë e Shqipërisë. Gjeneral Ruzhdi Saramati, komandantit të Brigadës së 128, i cili e udhëhoqi ofensivën heroike të Pashtrikut, bashkëluftëtar i ditëve të para i mr. Halil Alidemës, kur kujton Halilin, mes tjerash, pohon: "Halili ia stërviti Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës rreth 1800 luftëtarë të përgatitur. Një pjesë e madhe e tyre vinte nga Uniteti Kombëtar Shqiptar për bashkimin trojeve. Numerikisht i kishte 136 njësite që ishin në atë kohë të organizuara nga njësite treshe, pesëshe, shtatëshe, nëntëshe dhe njëmbëdhjetëshe. Por, pa Halilin nuk do të ishte arritur kjo punë e madhe që u bë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", thotë ai.

Figura dhe kontributi i Halil Alidemës për luftën çlirimtare të Kosovës nuk është vlerësuar aq sa duhet dhe si duhet, prandaj ishte koha e fundit që bashkëluftëtarët e tij, ata që me të ishin në agimet e ditëve të para ta vinin në vend nderi emrin e atdhetarit të shquar Halil Alidema. Prof. dr. Hysen Matoshi, në monografinë e tij "Mr. Halil Adidema - jeta dhe veprimtaria", ka arritur që ta ravijëzojë aktivitetin atdhetar të Halil Alidemës dhe jo vetëm kaq. Qasja mbi të cilën është ndërtuar kjo vepër shquhet me vlera të pamohueshme faktografike, të cilat me një gjuhë të pastër e stil të qartë shkencor, autori lëndën e mbledhur në arkiva të ndryshëm ka arritur asimilojë dhe përpunojë si dhe me analizat e tij të nxjerrë përfundime të qarta e të sakta, duke ndihmuar që lexuesit të kohës së sotme t'i ofrohet njohuri për të gjitha ato aktivitete që ndihmuan në rritjen e ushtrisë çlirimtare të Kosovës. Prandaj, kjo vepër do të jetë një kontribut i çmuar për ndriçimit e të gjitha lëvizjeve që i kanë paraprirë dhe kanë qenë pjesë e pandarë e fitores përfundimtare për lirinë e Kosovës. Si e tillë monografia "Mr. Halil Adidema - jeta dhe veprimtaria", e studiuesit prof. dr. Hysen Matoshi do të jetë një gur i çmueshëm në përkufizimin e lëvizjeve tona çlirimtare dhe burim i çmuar për shkrimin e historisë më të re të Kosovës.

Ministri Gashi në ShBA merr mbështetje nga drejtuesit më të lartë të YMCA-së

Nju Jork, 2 maj (ER) - Në kuadër të vizitës që është duke realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka zhvilluar takime me zyrtarë dhe drejtues të YMCA-së në Nju Jork. Ai gjatë kësaj vizite është pritur nga Rayda Marques, drejtoreshë e programeve ndërkombëtare të YMCA-së dhe Julie Galanty, drejtoreshë ekzekutive për zhvillimin e rinisë e YMCA-së në Nju Jork.

Ministri Gashi gjatë këtij takimi ka kërkuar mbështetje për zhvillimin e programeve rinore për të rinjtë e Kosovës, me theks të veçantë ndërtimit të kampit rinor në fshatin Pjetërshtan të Gjakovës.

Ministri ka potencuar faktin se ndërtimi i një qendre rinore multifunksionale në Republikën e Kosovës do t'u hapë edhe një perspektivë më të madhe të rinjve të Republikës së Kosovës. Në këto takime ministri ka marrë mbështetje të fuqishme në zbatimin e këtij projekti në Republikën e Kosovës. "Përvojat të cilat i kanë vendet e ndryshme të Botës, veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës për avancimin e pozitës së të rinjve, janë modeli më i mirë që duhet marrë si model për vendin tonë", ka thënë ministri Gashi.

Ministri Gashi ka njoftuar drejtuesit e YMCA-së se në Kosovë nevoja për përmirësimin e pjesëmarrjes së rinisë së Kosovës në aktivitete sociale vazhdon të jetë e rëndësisë së veçantë. "Nevoja e vazhdueshme për përkrahjen e rinisë theksohet edhe në raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare", ka thënë ministri duke shtuar se "themelimi i YMCA-së në Republikën e Kosovës është një mundësi e re për të rinjtë e vendit tonë".

E jashtëzakonshme

Adoleshentes i bëhet fytyra si gjarpër

Një adoleshente, e njohur si "Vajza gjarpër", është detyruar të jetojë ndryshe nga të tjerët për shkak të një gjendjeje të rrallë që e bën lëkurën e saj të rrjedhë gjak sa herë që ekspozohet ndaj dritës së diellit. Vedika Gupta, 13-vjeçare nga India, vuan nga çrregullimi gjenetik "ihtisyse", e cila e ka mbyllur atë në dhomën e gjumit.

FOTO E DITES

Një grua shihet duke ecur në La Paz të Bolivisë pranë një stalle të kokoshkave. /AP/

E rrallë

Keni vend edhe për një pasagjer?

Një luan ka tmerruar një shofere kur tentoi ta hapë derën e makinës me dhëmbë. Luani shihet në videon e postuar në rrjetet sociale duke i rënë me kthetra dorezës së derës dhe duke tentuar ta hapë atë. Video është regjistruar në një park kafshësh të egra në Afrikën e Jugut.

BARSOLETA E DITËS

Bie zilja e telefonit. E merr receptorin e zonja e shtëpisë:
- Zotëria është aty?
- Jo, por çfarë t'i them?
- Jepja, të lutem, 300 euro që ia mora borxh pardje. Unë doja të vija vetë, por më doli një punë urgjente.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER" 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck

Në ora19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight

Në ora21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Sot duhet të organizoheni sepse koha që keni në dispozicion nuk është e mjaftueshme për të mbyllur çdo aktivitet të menduar.



DEMI
Partneri ju mbështet dhe do të aprovojë çdo zgjedhje që ju bëni sot. Në këtë pikë është më mirë t'i tregoni mirënjohjen tuaj.

BINJAKËT
Duhet t'i evitoni në maksimum shoqëritë me njerëz që nuk ju pëlqejnë. Ata përçojnë një energji negative që mund t'ju afektojë.

GAFORRJA
Është më mirë që miqtë tuaj t'i dinë më përpara planet që keni në mënyrë që të mos gjenden përballë situatave të papritura.

LUANI
Ia vlen të harxhoni pak më shumë për të marrë atë shërbim që meritoni. Mos u kënaqni gjithmonë me ofertat e lira, se mund të zhgënjeheni.

VIRGJËRESHA
Kërkoni shumë dhe mbase nuk e vini re se personi i zemrës shumë herë ka problem ta kënaqë çdo kërkesë tuajën. Bëni mirë t'i diskutoni gjërat përpara.

PESHORJA
Evitoni impenjimet shumë të mëdha sot dhe merruni më tepër me veten. Ju shikoni shumë detajet tek gjërat për ta arritur perfeksionin.

AKREPI
Sot nuk do ta kuptoni se çfarë po kërkon një mik i juaji nga ju. Do të keqkuptoni një situatë të caktuar dhe më pas do të pendoheni.

SHIGJETARI
Sot duhet të bëni pushim total pa menduar për punën që ju pret ditën tjetër. E rëndësishme është ta shijoni të sotmen.

BRICJAPI
Të gjitha projektet që keni menduar për të ardhmen do të realizohen shumë shpejt. Jeni shumë korrekte me atë që po kërkoni nga të tjerët.

UJORI
Duhet të kuptoni që ata të cilët nuk ju duan, nuk ju meritojnë. Dëshira juaj për pavarësi shfaqet në çdo anë të karakterit.

PESHQIT
Mos pranoni shoqërinë e personave që duan t'ju manipulojnë me çdo kusht. Me mirë vetëm se me personat e gabuar.

Jennifer Lopezi jep hollësi mbi takimin e parë me të dashurin

Jennifer Lopezi ka folur për takimin e parë me Alex Rodriguezin. Gjatë paraqitjes së saj në "The Ellen Show", këngëtarja 48-vjeçare ka zbuluar atë që lojtari 42-vjeçar (i dashuri i saj) i shkroi në takimin e parë. Jen zbuloi se Alexi nuk mendonte se ky takim ishte serioz, sepse ai mendonte se këngëtarja po e shikonte dikë tjetër.

Ariana Grande paralajmëron albumin e ri "Sweetener"

Ariana Grande ka paralajmëruar se në këtë verë do ta sjellë albumin e ri "Sweetener". "Ky album është për ndriçimin e situatave të ndryshme, që të sjellësh dritë në jetën e dikujt, apo për dikë që sjellë dritë në jetën tuaj. Ëmbëlsim i situatave", ka thënë Grande. 24-vjeçarja nuk ka dhënë më shumë detaje rreth inspirimit për këtë album.

Dua Lipa merr dhuratë në Azerbajxhan

Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka performuar në Azerbajxhan në kuadër të turneut të saj në Azi. Përmes një fotografie të publikuar në rrjetin social "Instagram", Lipa ka bërë me dije se ka marrë për dhuratë edhe kapelën tradicionale të Azerbajxhanit.

Supermodeluesja publikon fotografitë e para nga dasma

Modelja Shanina Shaik ka publikuar imazhet e para të dasmës romantike me DJ Ruckus. Dasam e 27-vjeçares u zhvillua gjatë fundjavës në Bahamas. Supermodeluesja mbante veshur një fustan të bardhë shumë elegant të dizajnuesit britanik Ralph & Russo. Modeluesja e "Victoria's Secret" ka postuar disa fotografi ku shihet me bashkëshortin në plazh.

Shtatë vjet luftë, si duket jeta e përditshme në Siri

Si jetojnë njerëzit sot në Siri, shtatë vjet pas fillimit të luftës? Si duket jeta e përditshme? Frustrimet, frika, mungesa e shpresës dhe perspektivës…

"Para shpërthimit të luftës fitoja rreth 700 lira siriane në muaj dhe isha i kënaqur. Tani fitoj 10.000 lira në ditë dhe nuk mjaftojnë. Kam humbur besimin tek ekonomia vendore", thotë Sameri, një taksist në Damask. Ai ka ikur nga vendlindja e tij, Qodsiye dhe ka ardhur në kryeqytet.

Nuk ka para për ushqime

Prej fillimit të luftës civile në Siri, vlera e lirës siriane ka rënë me 90%. Përveç kësaj, shumë gjëra të nevojshme për jetën e përditshme nuk mund të gjenden fare, gjë që ka ndikuar në rritjen e madhe të çmimeve. Ndaj shumë sirianë janë të detyruar të kursejnë. Madje edhe gatimet janë shndërruar në gjëra luksoze. "Kam filluar të shfrytëzoj orizin dhe ushqimet e kualitetit të dobët. Aktualisht ha mish vetëm njëherë në muaj", thotë Jasmina, një grua e moshës 40-vjeçare, nënë e tre fëmijëve.

Ajo ka vështirësi të paguajë edhe qeranë për apartamentin në Damask, ku ka ardhur pas shpërthimit të luftës në vendlindjen e saj. "Më mirë të hash ushqim të keq sesa të jetosh në rrugë", thotë ajo.

Vallëzimet në luftë

Por jo të gjithë mendojnë për ushqimet, sikurse duket nga një shikim në restorante apo kafene. Tani ka më shumë restorante se para luftës. "Të kursesh? Deri kur? Deri sa nuk kam vdekur? Jo, ne jetojmë vetëm njëherë", thotë Taimi. "Nuk dua të flas për politikën, shkoj në dëfrime, pi vodkë të lirë dhe kënaqem duke vallëzuar me miq." 23-vjeçari rregullisht poston video në Facebook. Një prej këtyre vendeve është edhe bar Mazzika, në qendër të Damaskut. Taimi me shokë rri këtu deri në orët e para të mëngjesit, kur kthehet në shtëpi me makinë.

"Është rrezik, por frika me kohë zvogëlohet. Mësohesh dikur me frikën." Taimi qesh pas gati çdo fjalie. Mbase kjo është mënyra për të injoruar vizionin apokaliptik të një të ardhme të errët.

Zhdukja e profesioneve

Prej fillimit të luftës, nuk ka më të dhëna të sakta për gjendjen ekonomike. Por një është e qartë: profesione të tëra industriale janë zhdukur në tërësi. Dyqanet e mobilieve janë mbyllur. Nuk ka më as agjenci turistike dhe turizëm. Ndërsa lulëzon ekonomia ilegale. Kontrabanduesit transportojnë mallra në vijat e luftimeve dhe i shesin me çmime tepër të larta. Ata u japin ryshfet palëve dhe kalojnë nëpër linjat e luftimeve.

Qeveria e Sirisë po përpiqet që të përhapë lajme pozitive: "Eksporti i ilaçeve nga Siria po rritet. Katër laboratorë kanë marrë leje pune në vitin 2017", shkruan gazeta qeveritare Al-Thawra.

Sipërmarrjet e të rinjve

Të rinjtë megjithatë po përpiqen jo vetëm të mbijetojnë në këtë kohë, por edhe të punojnë. Ata kanë hapur edhe sipërmarrjet e tyre. "Hapja e sipërmarrjeve po ndodh së fundi në Damask, Aleppo dhe Homs. Kjo lejohet vetëm nëse siguron burimet e duhura financiare", thotë Maen Elhemmeh. Ai mendon se aktualisht në gjithë Sirinë ka rreth 500 start-up. Problemi i bizneseve të reja është mungesa e strukturës juridike në Siri. "Garancitë për sukses janë shumë të vogla", thotë Elhemmeh.

Shansi për femrat

Prej fillimit të luftës nga Siria janë larguar shumë akademikë. Kjo është humbje e madhe për ekonominë e vendit, por edhe një shans i ri. "Shumë sirianë kanë shkuar në Evropë, e një pjesë e tyre kanë mundësinë e përparimit në profesion", pohon Elhemmeh. "Kur të përmirësohet gjendja në Siri, ata mund të kthehen dhe të përdorin njohuritë e marra në Gjermani."

Femrat në Siri kanë filluar ndërkohë të punojnë në shumë profesione, të cilat më parë janë konsideruar si profesione meshkujsh. Gazeta Al-Ayyam shkruan se 58,3 % e fermave punojnë në punë të cilat më parë i kanë bërë meshkujt. Por këto të dhëna nuk janë përfshirë në statistikat zyrtare.

Femrat në qytetin Tartous punojnë si shitëse në rrugë, ngasin autobusë apo punojnë si automekanike. Në Damask ka femra që punojnë edhe si taksiste, që është një fenomen i ri. Shumë burra kanë ikur nga vendi apo janë futur në burgje. Ndaj shumë femra duhet të kujdesen për familjet. A do të ndikojë e gjitha kjo në përmirësimin e pozitës së femrave pas luftës, nuk është e sigurt.(gazeta-Shqip.com) DW

Çfarë dini për vitaminën D, zbuloni vetitë e saj!

E domosdoshme për kockat dhe dhëmbët, por jo vetëm: zbuloni se ku dhe si të bëni një furnizim të mirë të kësaj vitamine të rëndësishme

Vitamina D është thelbësore për funksionimin e duhur të trupit tonë, por fatkeqësisht për ne nuk është e pranishme në ushqim. Pra, nuk është e mjaftueshme një dietë e duhur, është e nevojshme të ekspozoni veten në diell për të qenë në gjendje për ta sintetizuar atë sa më mirë. Nëse do të kishim mundësinë të jetonim në një vend të bukur në plazh ose kohën për të ecur gjatë në ajër të pastër nuk do të ishte një problem, por nëse jetojmë në qytet ose gjithmonë punojmë në ambiente të mbyllura, çfarë mund të bëjmë? Le të përpiqemi ta kuptojmë njëri-tjetrin pak më shumë.

Mungesa e vitaminës D gjatë viteve të fundit është duke u bërë shumë më e shpeshtë, sidomos tek njerëzit e moshuar, shpesh të detyruar të qëndrojnë në shtëpi ose në strehimore ku nuk mund të shijojnë mjaftueshëm rrezet e diellit, ata që nuk mund të ekspozohen ndaj diellit për shkak të problemeve dermatologjike ose prania e sëmundjeve që ndërhyjnë në thithjen e vitaminës D siç është sëmundja celiac. Çfarë duhet të bëjmë, atëherë?

Aleate e grave: Vitamina D është thelbësore për fiksimin e kalciumit tek eshtrat. Natyrisht, për këtë arsye, më shumë kanë nevojë fëmijët në fazën e zhvillimit, zonjat që duhet të japin gjithçka që ju nevojitet për veten e tyre dhe për foshnjën, për ato më të vjetrat që hyjnë në menopauzë dhe kanë eshtra më delikate dhe poroze. Asnjëherë pa të!

Jo vetëm kockat: Përveç garantimit të një sistemi të fortë të skeletit, vitamina D gjithashtu vepron në shumë organe të tjera të tilla si zemra, mushkëritë dhe madje edhe në sistemin imunitar. Studimet e fundit tregojnë se vitamina D ndikon në parandalimin e sëmundjeve të caktuara, të tilla si diabeti i tipit 1, parandalon ose ngadalëson zhvillimin e kancerit duke ndaluar rritjen e qelizave dhe duke inkurajuar vdekjen e tyre të planifikuar. Nëse e gjithë kjo nuk është akoma e mjaftueshme, kjo vitaminë na mbron nga disa sëmundje të lëkurës, të tilla si psoriasis dhe dermatiti atopik. Shkurtimisht, një përqendrim i vërtetë i virtytit.

Shija e diellit: Dielli është mënyra më e mirë për t'u ngopur me Vitaminën D. Kini kujdes, megjithatë: nuk është e nevojshme që të piqeni me orë të tëra në plazh, por thjesht duhet të shmangni qëndrimin mbyllur në shtëpi. Natyrisht, midis punës, shtëpisë dhe familjes nuk është gjithnjë e lehtë, por t'i dedikosh pak kohë ekspozimit të lëkurës në diell është me të vërtetë e nevojshme. Një arsye e mirë për të ecur, vrapuar ose çiklizëm: si dhe duke u kënaqur, duke i bërë kockat tona më të forta si dhe mund të humbim edhe disa kilogramë, çfarë do të ishte më mirë?

Mirësia që vjen nga deti: Është e mundur të sigurohet një furnizim i mirë i vitaminës D edhe duke ngrënë disa ushqime si peshqit. Në fakt, vaji i mëlçisë së merlucit dhe disa peshq yndyrorë si salmon dhe harengë janë veçanërisht të pasur, por edhe e verdhë e vezës, mëlçia, mishi i kuq dhe perimet jeshile janë të shkëlqyera për të na dhënë këtë vitaminë të çmuar. Pra, le të përfitojmë nga pushimet në det për të bërë një festë të peshkut: kur thuhet të bashkosh nevojën me kënaqësinë…

Pak, por e mirë: Vitamina D sintetizohet nga lëkura kur rrezatimi diellor arrin një intensitet të caktuar. Pra, vera është sezoni kryesor për të bërë një stok të mirë, ndërsa në dimër fillon të mbarojë. Meqë sasia e vitaminës D që prodhon lëkura nën ndikimin e dritës së diellit ulet me rritjen e moshës, me shtimin në peshë (indet e yndyrës trupore tentojnë të mbajnë vitaminë D), si dhe me ndotjen e ajrit, por ajo që nuk duhet të harrojmë është që ta mbajmë trupin në formë, duke u kujdesur të mos marrim shumë yndyrë: njëzet minuta në ditë me armë, me fytyrë dhe këmbë të zbuluara për të na mbrojtur nga osteoporoza dhe sëmundjet e zemrës. Dy zogj me një gur! *(gazeta-Shqip.com)*

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE						
	ATLETICO MADRID - ARSENAL	GG	SV SALZBURG - MARSEILLE	3+	MARIEHAMN - TPS	3+

Drita dhe Prishtina marrin nga një pikë, gara për titull vazhdon

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 MAJ - Gara për titullin e kampiones në Vala Superligën e Kosovës në futboll vazhdon të jetë aktive, pasi dy skuadrat e para, Drita dhe Prishtina, kanë luajtur baras ndaj Gjilanit, përkatësisht Feronikelit. Fitoreve iu gëzuan Llapi dhe Trepça '89 në përballje me Drenicën dhe Lirinë e Prizrenit. Kjo xhiro përfundon sot (e enjten) me dy ndeshje mjaft interesante në mes të Vllaznisë së Pozharanit e Vëllaznimit dhe Besës e Flamurtarit.

Gjilani - Drita 1-1

Ashtu siç pritej të jetë interesant derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Gjilanit dhe Dritës, ashtu ndodhi pasi, përveç spektaklit në tribuna, nuk munguan as duelet e forta dhe golat e shënuara në fushë. Gjilani e nisi mirë ndeshjen duke tentuar ta ndëshkojë herët rivalen historike, Dritën. Rezultatin e parë vendësit e patën pas trembëdhjetë minutave lojë, kur Sadriu gjuajti nga distanca, por portieri Rexhepi ishte në vend. Dhjetë minuta më vonë edhe kapiteni i Gjilanit, Kastrati, tentoi të shënojë pas një rivënie nga këndi, por topi shkoi jashtë portës. Më pas Shabani i Dritës provon nga gjuajtja e lirë por, pa sukses. Kontrollin e lojës Gjilani arriti të konkretizojë në gol në minutën e 35-të kur, pas një aksioni të mirë të nisur nga Armend Thaqi, e përfundon me gol Ergon Hyseni. Derbi i Anamoravës filloi të bëhet edhe më interesant pas golit të parë dhe në minutën e dytë shtesë të pjesës së parë, Kastriot Rexha dëshmon formën e mirë, duke shënuar golin e katërmbëdhjetë personal, për barazimin 1-1. Në pjesën e dytë rastet nuk munguan për të dyja skuadrat, por rezultati 1-1 mbeti i pandryshuar dhe skuadrat morën nga një pikë nga ky derbi.

Feronikeli - Prishtina 0-0

Barazimin e lideres, Dritës, nuk e shfrytëzoi Prishtina e Mirel Josës, pasi luajti pa gola ndaj Feronikelit në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Rastet në derbin e dytë të kësaj xhiroje në futbollin e Kosovës nuk munguan, por gola të shënuara nuk pati dhe Prishtina vazhdon të jetë tri pikë pas Dritës në garën për titull. Xhiron e radhës Prishtina në Pejë e pret Gjilanin, kurse "Nikeli" i shkon Drenicës.

Llapi - Drenica 1-0

Llapi i Tahir Batatinës, pas dy humbjeve nga Drita dhe Prishtina, u është rikthyer fitoreve në ndeshjen ndaj Drenicës. Ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" e vulosi autogoli i Lushtakut në minutën e 49. Pas kësaj xhiroje Llapi zë vendin e tretë me 48 pikë, kurse Drenica pozicionohet e gjashta me tri pikë më pak.

Liria - Trepça '89 0-2

Kampionia aktuale e elitës, Trepça '89, e ka fituar ndeshjen ndaj skuadrës së Lirisë me rezultat 0-2. Sulmuesi kryesor i 89-shit, Otto John, e shënoi golin e parë pas njëzetë minutave lojë, kurse për 0-2 u përkujdes Arb Manaj (71'). Trepça '89 dhe Liria që synonin titullin e kampiones, tash ndajnë pozitat katër dhe pesë me nga 47 pikë të grumbulluara.

Sot përballen Besa - Flamurtari dhe Vllaznia (P) - Vëllaznimi

Dy ndeshjet e fundit të xhiros së 30 në Vala Superligë zhvillohen sot (e enjte). Pa dyshim se interesimi i të gjithë dashamirëve të futbollit është në Pejë, ku Besa e pret rivalin për pozitën e barazhit, Flamurtarin. Të dy kampet kanë paralajmëruar se në këtë ndeshje do të luajnë për fitore, në mënyrë që të kenë më të lehtë mbijetesën. Ndërsa strategu Gani Sejdiu do të debutojë si trajner i Vëllaznimit në ndeshjen që kuqezinjtë e zhvillojnë ndaj skuadrës së fundit në tabelë, Vllaznisë nga Pozharani. Të dyja këto ndeshje zhvillohen nga ora 16:00.

Vala SUPERLIGA

Liria-Trepça '89	0-2
Gjilani-Drita	1-1
Feronikeli-Prishtina	0-0
Llapi-Drenica	1-0

Të enjten takohen:
Vllaznia (P)-Vëllanzimi
Besa-Flamurtari

Tabela

1. Drita	60 pikë
2. Prishtina	57
3. Llapi	48
4. Trepça '89	47
5. Liria	47
6. Drenica	45
7. Gjilani	44
8. Feronikeli	43
9. Vëllaznimi	36
10. Flamurtari	19
11. Besa	19
12. Vllaznia	14

Në xhiron e radhës takohen: Trepça '89-Besa, Flamurtari-Vllaznia (P), Vëllaznimi-Llapi, Drenica-Feronikeli, Prishtina-Gjilani, Drita-Liria.

Sonte mësohen finalistet në Ligën e Evropës

MADRID, 2 MAJ - Pas Ligës së Kampionëve, sonte (e enjte) do të mësohen edhe dy skuadrat finaliste në Ligën e Evropës, garë mjaft e rëndësishme në futbollin evropian. Skuadra franceze, Marseille, është afër finales, pasi në ndeshjen e parë ka shënuar fitore ndaj skuadrës së Salzburgut (2-0), por Valon Berisha me shokë këtë edicion kanë bërë shumë befasi dhe Marseille duhet të ketë përqendrim maksimal në ndeshjen që zhvillohet në Austri.

Ndërsa në ndeshjen tjetër Atletico Madrid, pas barazimit në ndeshjen e parë ndaj Arsenalit (1-1), duket të jetë skuadër më e favorizuar. Goli i shënuar si mysafir dhe terreni vendës mund të jetë vendimtar në kualifikimin në finale, kurse në anën tjetër Arsenali do ta japë maksimumin për të shkuar në finale e më pas për ta fituar trofeun për trajnerin e tyre legjendar, Arsen Wengeri. Ky i fundit ka bërë me dije vendimin se në fund të këtij edicioni do të largohet nga Arsenali.

Sonte takohen:

21:05 Atletico Madrid-Arsenal	(1-1)
21:05 Salzburg-Marseille	(0-2)

Vëllaznimi angazhon Sejdiun në vend të Gojanit

GJAKOVË, 1 MAJ - Pas përfundimit të ndeshjes Vëllaznimi - Besa, e cila ka përfunduar 0-0, menjëherë është mbajtur një mbledhje nga kryesia e klubit dhe me marrëveshje me trajnerin Arsim Gojani, kanë vendosur ta shkëpusin bashkëpunimin e deritanishëm. "Kryetari i klubit, Agim Cana, menjëherë është interesuar që klubin mos ta lërë në këtë gjendje dhe ka arritur marrëveshje me Gani Sejdiun, një trajner me premisa të mëdha në kampionatin e Kosovës. Kjo marrëveshje është arritur falë respektit që Sejdiu ka për kryetarin Agim Cana dhe klubin gjakovar. Sejdiu është i gatshëm ta udhëheqë ekipin dhe ta bëjë maksimumin dhe të pamundurën që Vëllaznimi të mbetet në Superligë, sepse Superliga nuk e ka hijeshinë e duhur pa Vëllaznimin", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga Gjakova. Sejdiu e ka kryer të martën edhe stërvitjen e parë me skuadrën e Vëllanzimit, kurse debutimin do ta bëjë më 3 gusht në ndeshjen kundër Vllaznisë nga Pozharani.

FIBA nominon gjyqtarët e Kosovës për kampionatet evropiane

Prishtinë, 2 maj - Në adresë të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të mërkurën ka arritur nominimi nga FIBA Evropa për tre gjyqtarët: Xhelal Mumini, Daut Mehmeti dhe Dardan Maxhuni, të cilët do ta ndajnë drejtësinë në kampionatet evropiane të kategorive të reja që do të mbahen gjatë kësaj vere. Duhet theksuar se që nga pranimi në FIBA në vitin 2015, kjo është hera e parë që gjyqtarët e Kosovës nominohen për ta ndarë drejtësinë në gara të nivelit të lartë siç janë kampionatet evropiane të kategorive të reja, për shkak se vitin e kaluar pikërisht këta tre gjyqtarë janë licencuar nga FIBA.

Kosova, organizatore e Javës Evropiane të Sportit

Prishtinë, 2 maj - Shteti i Kosovës për herë të parë do të jetë nikoqir i Javës Evropiane të Sportit, nga 23 deri 30 shtator të këtij viti. Kjo iniciativë e Komisionit Evropian për ta promovuar sportin dhe aktivitetin fizik në tërë Evropën, sivjet do të organizohet për herë të parë edhe në Kosovë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), si përgjegjëse kryesore e zbatimit të politikave dhe organizimit të sportit në Republikën e Kosovës, është bartësja dhe kryesuesja e këtij procesi.

MKRS-ja ka themeluar Trupën Kombëtare Koordinuese për Organizimin dhe mbarëvajtjen e Javës Evropiane të Sportit në vendin tonë. Ekipi do të jetë në përbërje të: Daut Thaqi - këshilltar politik për sport - kryesues; Ibër Alaj - udhëheqës i Departamentit të Sportit - anëtar; Shasivar Haxhijaj - sekretar i Përgjithshëm në Komitetin Olimpik të Kosovës - anëtar; Njomza Emini - Komiteti Para Olimpik i Kosovës - anëtare; Brikena Mulliqi-Gashi - udhëheqëse e Departamentit të Integrimeve Evropiane - anëtare; Feim Hoxha - udhëheqës i Departamentit Ligjor - anëtar.

"Në vazhdën e takimeve kjo trupë në këtë fazë fillestare është mbledhur për planifikimin e agjendës së kësaj jave e cila do të organizohet edhe në Kosovë. Ndër çështjet që u diskutuan në këtë takim të parë ishin federatat të cilat do të marrin pjesë me aktivitetet e tyre në këtë javë, lokacionet nëpër qytete të ndryshme të Kosovës ku do të mbahen këto aktivitete dhe detaje të tjera të cilat mbeten të sqarohen më tej në takimet e radhës që kjo trupë do të mbajë. Në kuadër të Javës, përpos aktiviteteve të ndryshme sportive të natyrës garuese e fizike, do të organizohen edhe konferenca shkencore dhe seminare të ndryshme që kanë të bëjnë me edukimin sportiv, masivizimin dhe jetën e shëndetshme që ofron aktiviteti sportiv", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Java është organizuar në 32 vende deri më tani, me mbi 34 mijë ngjarje dhe 10 milionë njerëz që kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme.

Clevelandi mposht Toronton

Toronto, 2 maj - Cleveland Cavaliersi, nën udhëheqjen e një prej basketbollistëve më të mirë të historisë së NBA-së, LeBron James, fitoi 112-113 pas kohës shtesë përballjen e parë të serisë së gjysmëfinaleve në Konferencën e Lindjes ndaj Toronto Raptorsit. Ndoshta jo në versionin e tij më të mirë, por sërish vendimtar për suksesin e ekipit nga Ohio. "Mbreti" James e mbylli takimin me "triple double": 26 pikë, 13 asistime dhe 11 rikuperime, në plot 46 minuta mbi parket. Një fitore e pabesueshme e Cavsit, që qëndroi gjatë gjithë kohës në disavantazh, madje periodën e parë e mbylli me 14 pikë më pak se vendësit, 33-19, diferenca më e thellë e regjistruar gjatë kësaj sfide. Gjithsesi, në sekondat e fundit të kohës së rregullt arriti të barazojë 105-105, duke e çuar ndeshjen ne shtesë. Pikërisht në momentin më vendimtar të takimit, LeBroni me shokë treguan maturi, edhe pse duhet pranuar 3.5 sekonda nga fundi ishin me fat kur tentativa për tri pikë e Fred VanVleet të Raptorsit nuk përfundoi në kosh, raporton "Supersport".

Një sukses që mund të rezultojë vendimtar për Clevelandin në fund të serisë. Përveç Jamesit, në radhët e Cavsit spikatën Smithi e Korveri me 20 dhe 19 pikë, ndërsa lojtari më i mirë i skuadrës kanadeze, DeRozani, e mbylli përballjen me 22 pikë. Takimi i dytë i Serisë do të luhet sërish në "Air Canada Centre".

Golden State Warriorsi është i pandalshëm në Konferencën e Perëndimit. Kampionët në fuqi mposhtën 121-116 New Orleans Pelicansin edhe në përballjen e dytë të serisë së gjysmëfinaleve, duke thelluar avantazhin në 2-0. Në "Oracle Arena" u zhvillua një ndeshje e ekuilibruar deri në përfundim të periodës së tretë, që u mbyll 88-86, por në fraksionin e katërt Warriorsi krijoi një distancë sigurie prej 12 pikësh, duke lëshuar disi në fund, por pa e rrezikuar suksesin.

Kevin Duranti dhe Stephen Curry, i rikthyer në formën e duhur pas dëmtimit në gju, spikatën mbi parket, respektivisht me 29 dhe 28 pikë, ndërsa për Pelicansi Anthony Davis nuk mund të bënte më shumë, duke u ndalur në 25 pikë, 5 asistime dhe plot 15 topa të kontrolluar poshtë koshit. Sfida e radhës zhvendoset në "Smoothie King Center" të New Orleansit.

SHKURT

PSG-ja urdhëron Neymarin të rikthehet në Paris

Ylli brazilian Neymar thuhet të jetë urdhëruar nga klubi i tij Paris Saint-Germain të rikthehet menjëherë në Paris. Neymari është dëmtuar më 25 shkurt gjatë ndeshjes së kampionatit me Olympique Marseille dhe që as operacionit të tij në mars ai ka qëndruar në Belo Horizonte të Brazilit. Sipas stacionit televiziv "Esporte Interativo", Neymari pritet të rikthehet në kryeqytetin francez gjatë ditës së enjte. Aktualisht numri 10 i Brazilit është në fazën e riaftësimit. Ai pritet të jetë pjesë e përfaqësueses braziliane për Kupën e Botës që do të zhvillohet në Rusi. Kohët e fundit ai është përfolur edhe për një transferim te Real Madridi, por merkato e vërtetë pritet të fillojë pas Botërorit.

Zidane: Bayerni na vuri në vështirësi, tani të fitojmë në Kiev

Trajneri i Realit, Zinedine Zidane, është shfaqur mjaft i lumtur që arriti finalen e tretë radhazi në Ligën e Kampionëve. Gjithsesi francezi u tregua realist dhe pranoi se skuadra e tij vuajti shumë përballë Bayernit. "Të them të drejtën e nisëm shumë keq ndeshjen dhe në pjesën e parë vuajtëm shumë. Në të dytën ndryshuam diçka dhe vumë nën kontroll lojën, por duhet të pranoj se Bayerni dhuroi një paraqitje mjaft të mirë. Gjithsesi jam shumë i lumtur që jemi në finale dhe do të duhet të synojmë ta ngremë trofeun për herë të tretë", ka thënë Zidane.

Vitin e kaluar Reali theu rekordin me dy Liga të Kampionëve radhazi, ndërsa këtë vit ka mundësi ta thellojë atë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Zinedine Zidane, që ka fituar dy Liga të Kampionëve radhazi dhe për më tepër, ka mundësi të bëhet i pari trajner që fiton tri herë këtë kompeticion. "Dy finalet e para kanë qenë shumë të bukura, pasi i kemi fituar. Këtë të tretën duhet ta luajmë, por nuk e fsheh që do të doja të fitonim edhe në Kiev, pasi mendoj se e meritojmë. Kam një skuadër shumë të pjekur në fushë, që luan qetë dhe gjen momentin e duhur për ta goditur kundërshtarin", ka shtuar trajneri i Realit të Madridit.

Heynckesi: Ne e merituam finalen

Jupp Heynckes është shprehur i zhgënjyer me eliminimin e Bayern Munchenit nga Liga e Kampionëve. Trajneri gjerman ka thënë se skuadra e tij e ka merituar të jetë në finale. "Ashtu si skuadra ime, jam i zhgënjyer që nuk kemi kaluar. E meritonim të arrinim në finale, por nuk jam melankolikë. Kam një pamje realiste për rezultatin. Nëse shihni të dyja ndeshjet, ne ishim ekipi më i mirë. Duhet të ishim në finale, jam shumë i zhgënjyer. Nëse shikojmë ndeshjen e sotme, të dyja ekipet luajtën mirë, ishte një lojë e bukur, e klasës botërore. Ne kemi dominuar. Unë besoj dhe ata duhet të falënderojnë Navasin për performancën spektakolare, veçanërisht në fund", ka thënë Heynckes, duke shtuar: "Nuk e kisha parë Bayernin të luante aq mirë në një kohë mjaft të gjatë. Jam i zhgënjyer me rezultatin. Barazimi ishte një humbje për ne. Jemi stërvitur dhe kemi punuar për nëntë muaj, kemi ndërtuar një grup të mirë. Lojtarët e mi janë të gjithë të fortë dhe është një e vërtetë e turpshme që gjërat duhet të përfundojnë si kjo".

Jese dështon te Stoke, rikthehet te PSG-ja

Jese Rodriguez do të rikthehet te Paris Saint Germaini në verë. Lajmin e ka bërë të ditur klubi aktual i sulmuesit spanjoll, Stoke City. Jese Rodriguez këtë sezon ka luajtur në formë huazimi te Stoke nga PSG-ja. Për momentin lojtari është i dëmtuar, ndërkohë që me skuadrën angleze në këtë sezon ka zhvilluar në total 10 ndeshje, duke shënuar vetëm një gol. Një ecuri jo shumë pozitive kjo për një futbollist i cili ka luajtur edhe me Realin e Madridit dhe për ta blerë kartonin e tij nga "Los Blancos", PSG-ja shpenzoi 25 milionë euro.

Autor: GAZMEND MORINA

LLOJ VEGLE MUZIKORE
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM (shq.)
ZOG I EGËR GRABITQAR, I NGJASHËM ME BUFIN
VEGËL E METALTË, E PËRBËRË NGA DY KRAHË ME KOKË (sh.shq.)
OKSIGJEN, NIKEL
LLOJ QERREJE KUAJSH
ZANORE
RIFAT BERISHA
QULL I TRASHË ME MIELL MISRI
TITULL I PRONARËVE FEUDALË
FUTBOLLISTI FRANCEZ .... RAMI

BAZE E BOTËKUPTIMIT TË NJË NJERIU
LLOJ I NJË PRODHIMI SIPAS MADHËSISË, FORMËS E CILËSISË

VEND I PJERRËT I MBULUAR ME GURË TË RËNË NGA MALI (shq.)
AKTORI AMERIKAN ..... PITT (origj.)
KUNDREJT PRAKTIKA

SIPËRMARRËS I MADH PRIVAT
BISHË MALI (pashq.)

ANALISTI POLITIK BLERIM ....
DY ZANORE
OHIO, INDIANA
SKAJ MAGNETIK
BARKA PËR MBARTJEN E MALLRAVE

ISMET RAMUSHI
ANËCAK, GUR QË LIHET PAK JASHTË MURIT
TOROLLAK
SHKRIMTARJA JONË NERIMANE
BANOR I NJË QYTETI NË KOSOVË

A
KUNDREJT I HOLLOJ
LLOJ ËMBËLSIRE (sh.shq.)
SHKRONJA XV
EMËR YNI DJALI

SHTET (fr.)
INTERNATIONAL ISLAMIC UNIVERSITY
DY BASHKËTINGËLLORE
KËNGËTARJA KANADEZE MORISET

EPOKA E RE

FUTBOLLISTI NË FOTO MARKIZIO
RADHA
... NOKSHIQI
MANIA, HUQI
SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË
AKTORI YNË .... FLLOKO
TAJVANI, INDONEZIA
QENGJI I BUTË
DY ZANORE

RRIPI QË E LIDHIN BURRAT SI NYJË RRETH QAFËS
BOR, RADIUM, ELEKTRON
QËLLOVA RASTËSISHT NË NJË NGJARJE
AKTORI FRANCEZ .... DELON
BUJK

TMERR
RRJETËZA E SYRIT
"LAUNDER"
TENISTJA KURNIKOVA
FUTBOLLISTI .... FETAHU

AKTORJA ISMAILI
NJOLLA
RESEARCH KANDER ASSOCIATIO.
MJET TRANSPORTI
KLUB FUTBOLLI NË SUEDI
BASHKËT.
ISH FUTBOLLISTI EDVIN .....

URIM DAKAJ
I PREVA DEGËT E NJË PEME
JEPEM SHUMË PAS DIÇKAJE
MBAJTJE E ANËS
ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI
ZYRTARIZIMI I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

LETRARI MEHMETI
QË DO ZGJIDHJE TË SHPEJTË
DËMTIM I NJË MAKINE GJATË LËVIZJES
AKTORJA E FAMSHME ZELLWEGER
I ÇMENDUR
GRUP VALLTARËSH (shq.)

ZANORE
SHKRONJË GREKE
TRISKA, KUPONI
SHTET NË AZI
VIOLINISTJA SHQIPTARE .... GEGA
SIENA
AI QË KËNDON ROK (pashq.)
RAMADAN AVDIU
DJALLEZORE

KRYEQYTETI I KANADASË
QYTET I MADH NË GJERMANI
DRAMË E SANTORIT
DERË E VOGËL E THURUR ME THUPRA (sh.shq.)

EPOKA E RE
TOKA E BUKËS
ZËRI I FORTË QË NXJERR NJERIU KUR BËRTET
AKTORJA AMERIKANE LINDA .....
ZANORE
DY ZANORE
NOTË MUZIKORE
KALI I STËRVITUR
GRIMCA MOLEKULARE

GJELBËRIMI
PIANISTJA ALBERTA
ENGLISH ADDITIONAL LANGUAGE
ANA RUSO
TITULL QË MBANTE NË DISA VENDE MYSLIMANE KRYESUNDIMTARI
THEP, CEP

REGJISORI ... QOSJA
SHKRIMTARI .... ZOLA
MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI (sh.pashq.)
KËNGËTARJA ANA ....
ZANORE
AKTORI PRAPASHTICA

LIDHJE A BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA
EDI RAMA
NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE
SKLLAV
SHKRONJA TË NJËJTA
DASHUROR
KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK

TITAN
AKTORI EGJIPTIAN .... SHARIF
AGIM TEJECI
VIDEO SPOT MUZIKOR
DY ZANORE
PJESË E LIMANIT
DY BASHKËTINGËLLORE

BASHKËT.
PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE (Nofka)
RAVENA
HUMORISTI KIÇINA
EVERTON
LËSHIM NGA BURGU
BASHKËT.

TËRËSIA E ARMATIMEVE LUFTARAKE
AKTORI YNË ... ISLAMI
ERBIUM, INTENSITET

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "BALLKAN-L", N.T.SH me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: Nrb. Biznesit: 71006271 dhe nr.fiskal: 601038559 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "BALLKAN-L" N.T.Sh od Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : Nrb. Biznesit: 71006271 i broj fiskala: 601038559 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "BALLKAN-L", N.T.Sh in Gjakova, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 71006271, i number fiskal: 601038559 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance
Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo

Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV007-18

Afati dhe Lloji	2 Vite– Obligacion Qeveritar
Shuma e Ofruar	€20,000,000
Kodi i Instrumentit	KV1212011200
Data e Ankandit	10.05.2018
Data e Shlyerjes	11.05.2018
Data e Maturimit	11.05.2020
Mekanizmi i Çmimit	Çmime të Shumëfishta

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blerje të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Announcement of Securities Auction KV007-18

Term and Type	2 Years – Government Bond
Offering Amount	€20,000,000
Instrument Code	KV1212011200
Auction Date	10.05.2018
Settlement Date	11.05.2018
Maturity Date	11.05.2020
Pricing Mechanism	Multiple Price

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV007-18

Rok i Tip	2 Godina – Drzavna Obveznice
Ponuđeni Iznos	€20,000,000
Instrument kod	KV1212011200
Datum Aukcije	10.05.2018
Datum Poravnanja	11.05.2018
Datum Dospeća	11.05.2020
Mehanizam Cene	Visestruka Cena

Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznice preko operacija definisanih u Uredbi o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Državnih Hartija od Vrednosti.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 246

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Ismaili

C.nr.313/2017.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, **Departamenti i Përgjithshëm Div. Civil,** Gjyqtari **Jonuz Bugari**, në çështjen juridike të paditësve Gani Sejdi Berisha, Selim Sejdi Berisha, Refki Sejdi Berisha dhe Besnik Qerim Berisha të gjithë nga fshati Brestovc, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson Myhedin Bekeri, Avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat të lëndës, kundër të paditurve Refki Iliaz Berisha, Hamz Iliaz Berisha, Drita Berisha, Enver Nazmi Berisha, Ilir Nazmi Berisha, Teuta Nazmi Berisha dhe Gjafer Nazmi Berisha, të gjithë nga Prizreni, të paditurit Drita, Enver, Ilir, Teuta dhe Gjafer gjinden në Zvicër, tani në adresë të panjohur, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim, më datë **12.04.2018.** merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurve Drita Berisha, Enver Nazmi Berisha, Ilir Nazmi Berisha, Teuta Nazmi Berisha dhe Gjafer Nazmi Berisha të gjithë nga Prizreni, të cilët gjinden në Zvicër, në adresë të panjohur **I'U CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Zyber Zeka, Avokat nga Rahoveci.

Përfaqësuesi i përkohshëm në këtë procedurë, i ka të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor. Këto të drejtat dhe obligimet përfaqësuesi i përkohshëm do të i kryen gjeri sa të paditurit Drita, Enver, Ilir, Teuta dhe Gjafer Berisha, ose përfaqësuesi i tyre të paraqitet në gjykatë, respektivisht kur Organi i Kujdestarisë i QPS-së në Rahovec e njofton gjykatën për caktimin e kujdestarit.

Aktvendimi do të iu dërgohet përfaqësuesit të paditësve, përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve si dhe të shpallet do të publikohen në Gazetën Zyrtare e Republikës të Kosovës, në një nga gazetat të përditshme ditore në Kosovë, në tabelën e shpalljeve të Gjykatës si dhe një kopje do të i dërgohet Organit të Kujdestarisë të QPS-së në Rahovec.

A r s y e t i m

Të paditurve Drita, Enver, Ilir, Teuta dhe Gjafer Berisha, në këtë çështje juridike i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm, me propozimin e përfaqësuesit të paditësve Avokatit Myhedin Bekeri, meqenëse të paditurit gjenden në adresë të panjohur në Zvicër. Arsyerat për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm janë të cekura në dispozitiv të aktvendimit.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 79 al. 3 pika a, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, më datë 12.04.2018.

Gjyqtari
Jonuz Bugari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

NJOFTIM

Njoftojm te gjith klientet se Kompania "MICKEY MAUSE shpk me seli ne Sadik Rexha nr78 Prizren ka marr vendim te shuaj biznesin me **NRB 810003723** dhe ka caktuar likujdatorin per zhvilimin e procedures se Likujdimit.Njoftojm te gjith klientet qe kan raporte debitore-kreditore ne kete shoqeri te paraqiten ne afatin 30 –ditor nga data e shpalljes ne gazet.

OBAVESTENJE

Obavjestavamo sve kliente da Tvrka "MICKEY MAUSE D.O.O. iz Sadik Rexha nr78 Prizren ,doneo odluku da ugasi biznis po Br.Registra **810003723** u jedno imenovano Likfidatora o sprovodjenju postuaka likfidacije.Obastavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanje u u navedenoj firmi,da se javi u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All klients are to be informed that the Company "MICKEY MAUSE L.L.C. pLAV in Sadik Rexha nr78 Prizren has come to the decision to quit its with registry. **NRB 810003723** The Company has appointed a liquidator whois going to Oversee th liquidator process.All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30days starting from the day of newspaper announcement publication.

Drejtor Ekzekutiv

Prizren
02.05.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova

Komuna e Prizrenit
Cumhuriyeti Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës nr. 01/060-58626 të datës 13.04.2018, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren - Komisioni për ndarjen e bursave të studentëve, shpall:
Nr. 1174/18 Datë 02.05.2018

KONKURS
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN AKADEMIK 2017/18

I.	**FAKULTETI FILOZOFIK**	
1	Dega e Etnologjisë	1
	Socjologji	1
	Psikologji	1
	Filozofi	1
	TOTALI	**4**
II.	**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE**	
1	Biologji-drejtimi Ekologji - mbrojtje e ambientit	1
2	Fizikë-drejtimi arsimor	1
3	Kimi -drejtimi arsimor	1
4	Matematikë-drejtimi i shkencave kompjuterike	2
5	Matematikë e përgjithshme	2
	TOTALI	**7**
III.	**FAKULTETI I FILOLOGJISË**	
1	Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	2
2	Dega e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe	2
3	Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane	2
4	Dega e Gjuhës Boshnjake	1
5	Dega e Gjuhës Turke	1
	TOTALI	**8**
IV.	**FAKULTETI JURIDIK**	
1	Drejtimi i përgjithshëm	4
	TOTALI	**4**
V.	**FAKULTETI EKONOMIK**	
1	Departamenti Banka, Financa dhe Kontabiliteti	2
2	Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	2
3	Departamenti i Marketingut	2
	TOTALI	**6**
VI.	**FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS**	
1	Drejtimi i Konstruktiv	1
2	Drejtimi i Hidroteknikës	1
3	Drejtimi Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor	2
4	Drejtimi i Gjeodezisë	2
5	Seksioni Arkitekturës	1
6	Inxhinieri e ambientit	1
	TOALI	**9**
VII.	**Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike**	
1	Departamenti i Telekomunikacionit	1
2	Departamenti i Elektronik	1
3	Departamenti i Automatikës	1
4	Departamenti i Sistemeve Elektroenergjetike	1
	TOALI	**4**
VIII	**Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike**	
1	Drejtimi Prodhimtari dhe Automatizëm	1
2	Drejtimi Teknika e ngrohjes dhe termoenergjetikës	1
3	Drejtimi Komunikacion rrugor	1
	TOTALI	**3**
IX.	**FAKULTETI I MJEKËSISË**	
1	Dega e Mjekësisë së përgjithshme	2
2	Dega e Stomatologjisë	2
3	Dega e Farmacisë	2
4	Dega e Mami	2
5	Dega e Fizioterapi	2
6	Infermieri	2
	TOTALI	**12**
X.	**FAKULTETI I ARTEVE**	
Dega:	art figurative, dramatik dhe muzikor (nga nje per secilin drejtim)	3
XI.	**Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**	
	TOTALI	**4**
XII.	**FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE**	
	TOTALI	**2**
XIII.	**FAKULTETI I EDUKIMIT**	
1	Pedagogji e përgjithshme	1
2	Programi fillor	5
3	Parashkollor	2
4	Drejtimi fëmiri e hershme	2
	TOTALI	**10**
1	Software Desing (UPPz)	1
2	Administrim Biznesi (UPPz)	1
3	Menaxhment Ndërkombëtar (UPPz)	1
4	Teknologji e Informimit dhe Telekomunikimit (UPPz)	1
	TOTAL	**4**
TOTALI I PËRGJITHSHËM I BURSAVE:		**80**

Kushtet:

Studentët e interesuar për konkurrim duhet të parashtrojnë këto dokumente:

1. **Certifikatën e vitit të regjistrimit akademik 2017-2018, duke e cekur:**
   a) se është student i vitit të dytë, tretë, katërtë e pestë,
   b) se i ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e shtatorit - tetorit 2017
   c) notën mesatare gjatë studimeve të vërtetuar nga fakulteti
   d) se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve
2. **Certifikatën e provimeve të dhëna me datat e dhënies së provimeve.**
3. **Vërtetimin se është fëmijë i dëshmorit dhe fëmijë i invalidit të luftës (**kjo vlen vetëm për ata kandidatë që janë fëmijë të dëshmorit dhe të invalidëve i cili dokument nxirret ne Shoqatat e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës në Prizren)
4. **Dëshminë se kandidati merr ndihmë sociale të konfirmuar me dokument nga Qendra për Punë Sociale në Prizren (**kjo vlen vetëm për ata kandidatë, që familja e tyre e gëzojnë të drejtën e asistencës sociale).
5. **Të drejtë konkurrimi për realizimin e bursës kanë studentët - kandidatë që janë banorë të Komunës së Prizrenit dhe të konfirmohet me certifikatën e vendbanimit, të ketë notë mesatare mbi 8.00, të cilët kanë fituar të drejtën e regjistrimit të vitit: II-III-IV-V- në vitin akademik 2017/2018 në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës e jo edhe në ato private dhe jashtë shtetit.**
6. Studentët që janë përfitues të bursave Universitare dhe ata që janë në marrëdhënie pune, nuk kanë të drejtë të jenë edhe përfitues të bursës komunale në Prizren.
7. Fletëparaqitja për aplikim dhe informatat shtesë merren në zyrën e pranimit në DKA
8. Bursa ndahen vetëm për studentë e studimeve bazë e jo edhe për MASTER.
9. Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm në drejtimet e shpallura ne konkurs, në të kundërtën dokumentet e tyre nuk shqyrtohen, pasi konkurrenca zhvillohet brenda drejtimeve.
10. **Afati i paraqitjes se aplikacionit zgjat nga data 02.05.2018 e gjere më 16. 05. 2018**
11. Pas mbylljes së afatit të aplikimit, komisioni shqyrton dokumentacionin dhe bën listën propozues sipas kushteve të lartcekura dhe e publikon atë në tabelën e shpalljeve në DKA.
    a) Në afat prej 5 ditësh kandidatët kanë të drejtë ankese në listën propozues.
    b) Pas shqyrtimit të ankesave, miratohet lista përfundimtare dhe publikohet nga komisioni për ndarjen e bursave, pas konfirmimit të saktësisë së të dhënave në certifikatën e provimeve (notave), lidhet Kontrata mes përfituesit të bursës dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren.

Renditja e Kandidateve

12. **Renditja e kandidatëve në listën prioritare bëhet në bazë të këtyre kritereve:**
    a) Suksesi në studime: 50 pikë maksimale / të mundshme.
    b) Studentët e vitit: III, IV, V dhe VI marrin nga 2 pikë shtesë për çdo vit.
13. **Për suksesin e studimeve kandidati fiton këto pikë:**
    a) për notën mesatare 10 (dhjetë / 9.50-10.00) = 50 pikë
    b) per notën nesatare 9 (nëntë / 9.00-9.49) = 45 pikë,
    c) per notën mesatare 8.0 (tete) (8.00-8.99) = 35 pikë

14. Kandidateve / studenteve te prindereve Dëshmor të luftes ju shtohen 15 pike, Invalid te luftes 10 pike dhe te rasteve sociale 5 pike.

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në DKA



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ D.P.H. "Nora" shpall të pavlefshme certifikatën me numër të biznesit - NRB 70188471, Skenderaj.

▶ Besmir Ukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

▶ Getoar Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Sokol Demaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII Shf "Bajram Curi" Romajë.

▶ Kaltrina Kokollari shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLM "Luciano Motroni" Prizren.

▶ Herolind Ferati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Vaxhide Sylejmani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLM "Luciano Motroni" Prizren.

▶ Hidajete Perolli shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion

AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333